FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 8	2000	Prill

P Ë R M B A J T J A

Dekret nr.2569, datë 2.3.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	311
Vendim i KM nr.110 datë 9.3.2000	Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2000 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Ministrisë së Financave	311
Vendim i KM nr.114 datë 16.3.2000	Për prokurim të drejtpërdrejtë të fondeve për auditimin e Shoqërisë Anonime "AMC"	313
Vendim i KM nr.117 datë 16.3.2000	Për miratimin e projektit "Ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për Institutin e Sigurimeve Shoqërore"	313
Vendim i KM nr.118 datë 18.3.2000	Për miratimin e kontratës për dhënien me koncesion, të formës "ROO", të Uzinës së Superfosfatit në Laç, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë "Evertrade, S.a."	314
Vendim i KM nr.119 datë 18.3.2000	Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët	315

	jostrategjikë	
Vendim i KM nr.122 datë 18.3.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohet nga shteti"	323
Vendim i KM nr.123 datë 18.3.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë"	325
Vendim i KM nr.126 datë 23.3.2000	Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet	326
Vendim i KM nr.127 datë 23.3.2000	Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik	327
Vendim i KM nr.138 datë 23.3.2000	Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik	329
Vendim i KM nr.145 datë 31.3.2000	Për riorganizimin e qendrave studentore	331
Vendim i KM nr.147 datë 31.3.2000	Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet	332
Vendim i KM nr.148 datë 31.3.2000	Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura Grant nga Japonia në kuadër të projektit "Shtimi i prodhimeve ushqimore", 2 KR	334
Vendim i KM nr.149 datë 31.3.2000	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që zë rehabilitimi i aksit rrugor Durrës-Rrogozhinë	335
Vendim i KM nr.173 datë 13.4.2000	Për lejimin e ekspozimit të një vëllimi origjinal, të restauruar të "Codex Beratinus Purpureus" (shekulli VI)	335
Vendim i KM nr.179 datë 13.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare", ndryshuar me vendimin nr.122, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave	336
Vendim i KM nr.181 datë 13.4.2000	Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, të Ministrisë së Transportit, për riveshjen pjesore, në rrugët Tiranë-Ndroq-Plepa dhe Vorë-Durrës me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë	337
Vendim i Gj.K nr.65	Me objekt "Papajtueshmërinë me kushtetutën të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje"	338
Vendim i Gj.K nr.7	Me objekt "Shpalljen antikushtetuese të vendimeve nr.38, datë 17.7.1998 të Gjykatës së rrethit Gjirokastër, nr.23, datë	346

	14.10.1998 të gjykatës së apelit Gjirokastër dhe nr.66, datë 10.3.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë	
Vendim i Gj.K nr.8	Me objekt "Interpretimin e nenit 179 pika 1 dhe nenit 127 pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës	350
Vendim i Gj.K nr.11	Me objekt "Detyrimin e Ministrit të Drejtësisë të japë lejen për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit civil nr.1808, datë 24.4.1997 të Gjykatës së rrethit Tiranë"	352
	Vendim i Gj.L nr.386	354

DEKRET
Nr.2569, datë 02.03.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Valedin Belul Tahiri
2. Alfred Shefqet Ferra
3. Ridvan Haxhi Mileti
4. Iris Shaban Reuther (Fagu)
5. Rezart Sali Mako
6. Rexhep Shefik Sherri
7. Dhurata Asim Schauer (Jarani)
8. Artan Bedri Halebi
9. Vjollca Habip Tufa (Voda)
10. Xhevrie Javer Kore (Nuredini)
11. Namik Naim Mulliqi
12. Jona Namik Mulliqi
13. Majlinda Sami Mulliqi (Guçe)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

VENDIM
Nr. 110, datë 9.3.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2000 TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në mbështetje të neneve 100, 159 dhe 163 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 10, të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", të nenit 12, të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993, "Për buxhetin lokal", të nenit 24, pika 1, dhe nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Pushtetit Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në kuadrin e ristrukturimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të aktit të nxjerrë nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtoritë rajonale të këtij organi kalojnë në sistemin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Ministrisë së Financave, për të plotësuar strukturat e kontrollit.

2. Nga 166 punonjës të cilët i pakësohen Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, 151 punonjës i shtohen Ministrisë së Pushtetit Vendor, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe 15 punonjës i shtohen Ministrisë së Financave.

3. Për efekt të zbatimit të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi në buxhetin e shtetit të vitit 2000 bëhen këto ndryshime:

a. Kontrollit të Lartë të Shtetit i pakësohen 22 000 000 (njëzetedy milionë) lekë, nga të cilat 15 599 000 lekë fond pagash, 3 189 000 lekë sigurime shoqërore dhe 3 212 000 lekë shpenzime operative.

b. Ministrisë së Pushtetit Vendor i shtohen 19 650 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqindepesëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat 13 932 000 për pagat, 2 849 000 lekë për sigurimet shoqërore dhe 2 869 000 lekë për shpenzime operative.

c. Ministrisë së Financave i shtohen 2 350 000 (dy milionë e treqindepesëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat 1 667 000 lekë për pagat, 340 000 lekë për sigurimet shoqërore dhe 343 000 lekë për shpenzime operative.

4. Inventari i pajisjeve, i mjeteve të transportit dhe mjediset e zyrave të degëve rajonale të Kontrollit të Lartë të Shtetit i kalojnë sistemit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Ministrisë së Financave, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA NR.1

Numri i punonjësve në Sektorët e Kontrollit në Prefektura

1. Prefektura Berat	8
2. Prefektura Dibër	10
3. Prrefektura Durrës	10
4. Prefektura Elbasan	12
5. Prefektura Fier	12
6. Prefektura Gjirokastër	10
7. Prefektura Korçë	12
8. Prefektura Kukës	12
9. Prefektura Lezhë	8
10.Prefektura Vlorë	10
11.Prefektura Shkodër	12
12.Prefektura Tiranë	15
Totali	**131**
MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL	20
MINISTRIA E FINANCAVE	15

VENDIM
Nr. 114, datë 16.3.2000

PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË TË FONDEVE PËR AUDITIMIN E SHOQËRISË ANONIME "AMC"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995,

"Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet shoqëria anonime "AMC" të prokurojë, me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë, fondin prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, me shoqërinë Deloitte & Touche, për auditimin e kompanisë (revizionimin e llogarive të vitit 1999), në kuadër të privatizimit të saj.

2. Ky fond të përballohet nga shoqëria anonime "AMC".

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqëria anonime "AMC" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 117, datë 16.3.2000

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I KAPACITETEVE KOMBËTARE PËR INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.116, datë 24.2.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave dhe ndihmave të huaja, që i jepen qeverisë së Republikës së Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit "Ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", të financuar me shumën 400 400 (katërqind mijë e katërqind) USD, nga të cilat 350 400 (treqindepesëdhjetë mijë e katërqind) USD do të financohen nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD).

2. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ngarkohet institucion përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij projekti, në përputhje me objektivat e parashikuara në projekt.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e projektit dhe për përballimin e shumës prej 6 700 000 (gjashtëmilionë e shtatëqind mijë) lekësh (ekuivalent i 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD-ve, si kosto vendore, e parashikuar në projekt.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 118, datë 18.3.2000

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR DHËNIEN ME KONCESION, TË FORMËS "ROO", TË UZINËS SË SUPERFOSFATIT NË LAÇ, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË "EVERTRADE, S.A."

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 3, pika 6,dhe neneve 4 dhe 9, pika 3, të

ligjit nr .7973, datë 26.7.1995, "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontratës për dhënien me koncesion, të firmës "ROO", për rehabilitimin e Uzinës së Superfosfatit, Laç, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë "Evertrade", S.a .

2. Paragrafi i katërt, në nenin 6 të kontratës së koncesionit është i vlefshëm pas miratimit të ligjit përkatës nga Kuvendi.

3. Punonjësit, që do të ndërpresin punën me fillimin e kësaj kontrate dhe nuk zhvillojnë veprimtari, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, do të trajtohen financiarisht me pagën minimale, për një periudhë njëvjeçare. Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2000. Periudha njëvjeçare, për punonjësit që do të trajtohen sipas këtij vendimi, njihet si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 119, datë 18.3.2000

PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8334, datë 23. 4. 1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorin jostrategjik.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda 5 ditëve nga dita e nxjerrjes së urdhrit të ministrit, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dokumentacionin për privatizimin e shoqërisë, që shërben për të gjitha format e privatizimit sipas këtij vendimi, në origjinal ose të njëhsuar me të, i cili përmban:

a) Urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për fillimin e procedurave të privatizimit.

b) Aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

c) Vendimin e regjistrimit të shoqërisë si person juridik në gjykatë me ndryshimet e bëra në të.

ç) Bilancin e shoqërisë.

d) Raportin e ekspertit kontabël.

dh) Genplanin, planvendosjen e shoqërisë, të lëshuar nga zyra e urbanistikës së qytetit/ rrethit përkatës.

e) Aktvlerësimin e truallit të shoqërisë.

ë) Vërtetimin nga Qendra e regjistrimit të aksioneve për regjistrimin e shoqërisë që privatizohet, kur shoqëria ka mbi 50 aksionerë.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda 10 ditëve nga mbërritja e dokumentacionit, shqyrton rregullsinë e tij. Kur në dokumentacionin e dërguar vërehen parregullsi të kërkesave të pikës 2 të këtij vendimi, Agjensia Kombëtare e Privatizimit e kthen atë në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për plotësim.

4. Me Publikimin e shoqërisë për privatizim, asaj i ndalohet të bëjë çdo ndryshim kapitali, të marrë hua apo kredi.

I. Procedurat për përcaktimin e formulës së privatizimit.

A. Publikimi.

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, AKP-ja fillon menjëherë publikimin. Periudha e publikimit zgjat 30 ditë dhe bëhet në tri gazeta me qarkullim kombëtar nga tri herë në secilën gazetë.

2. Publikimi përmban këta elemente:

- Emrin e shoqërisë tregtare;
- Selinë e shoqërisë;
- Kapitalin themeltar dhe numrin e aksioneve të shoqërisë tregtare;
- Sipërfaqen e truallit të shoqërisë, të lirë dhe të mbuluar;
- Objektin e veprimtarisë;
- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë pranë shoqërisë;
- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit;
- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve që ish-pronarët e truallit duhet të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

3. Brenda periudhës së publikimit në gazetat me qarkullim kombëtar, degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe vendosin afishe, me të dhënat e publikuara për shoqëritë që privatizohen, pranë shoqërive që ndodhen në rrethin përkatës.

4. Në fund të periudhës së publikimit Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e kësaj agjencie në rrethe mbajnë një procesverbal për vendosjen e pranë shoqërive të afisheve, me të dhënat e publikuara dhe mbylljen e publikimit.

B. Procedurat e llogaritjes së paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë.

1. Punonjësit e shoqërisë, brenda 10 ditëve nga dita e parë e publikimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, duhet të paraqesin pranë shoqërisë çertifikatën e gjendjes familjare, lëshuar nga zyra e gjendjes civile pas datës së publikimit, me anë të së cilës përcaktohen anëtarët që përfitojnë bono privatizimi.

2. Shoqëria lëshon vërtetimin për identitetin e punonjësit, periudhën e punësimit ose datën e daljes së tij në asistencë, për trajtimin me pagesë papunësie.

3. Shoqëria, në bazë të këtij dokumentacioni, brenda 25 ditëve nga dita e publikimit për fillimin e procedurës së privatizimit, I dërgon Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të dhënat, sipas formularëvetë përcaktuar prej kësaj të fundit.

4. Brenda 30 ditëve, nga data e publikimit të radhës, punonjësit e shoqërisë bëjnë regjistrimin e kërkesave për zotërim aksionesh në këmbim të bonove të privatizimit në Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në bazë të përcaktimeve të pikave 1, 2 dhe 3, të shkronjës “B”, të këtij vendimi.

5. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë, me vlerë nominale, bonot e privatizimit, të tyre, dhe ato të familjes, në aksione të shoqërisë. Pjesëmarrja e punonjësve në aksione të shoqërisë, do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së bonove familjare të privatizimit, të dorëzuara, të cilat ata i zotërojnë sipas legjislacionit në fuqi (Dekreti nr.1030, datë 1. 11.1996, ndryshuar me akte të tjera ligjore), në raport me kapitalin themeltar të shoqërisë. Përqindja e aksioneve të tyre mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

6. Punonjës të shoqërisë janë punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë, sipas ligjit nr.7521, datë 30. 10.1991, “Për përkrahjen sociale për personat që dalin pa punë nga zbatimi i

reformës ekonomike".

Për punonjësit e asistencës ruhet e drejta që nga publikimi i parë për privatizim.

C. Procedurat për llogaritjen e paketës së aksioneve për ish-pronarët e truallit.

1. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim nga subjektet e tjera kërkuese, në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15. 4. 1993, "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve ndryshuar", ndryshuar me akte të tjera ligjore, kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave ish-pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, përcaktuar sipas vendimit nr.312, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave.

2. Pjesëmarrja në aksione të shoqërisë për ish-pronarët e truallit do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së truallit të llogaritur për ish-pronarët, sipas kritereve të mësipërme, në raport me kapitalin themeltar të shoqërisë.

3. Ish-pronari i truallit, për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve. Ai zotëron një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar, në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

4. Brenda 30 ditëve nga data e parë e publikimit, ish-pronarët e truallit duhet të paraqesin në AKP, në origjinal:

- kërkesën me shkrim për zotërim aksionesh në kapitalin e shoqërisë që privatizohet, në përpjesëtim me vlerën e truallit që atij i njihet nga vendimi përkatës i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave të ish-pronarëve.
- vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave ish-pronarëve, së bashku me gentplanin e hartuar nga ky komision.
- dëshminë e trashëgimisë dhe prokurën e përfaqësimit të posaçme.
- një vërtetim nga Komisioni i Kthimit e Kompensimit të pronave të ish-pronarëve, ku të konfirmohet se për sipërfaqen e truallit, ish-pronë e tij, që ish-pronari kërkon të kompensohet me aksione në shoqërinë përkatëse nuk është kompensuar më parë me njërën nga format që njeh ligji.

D. Formula e privatizimit

1. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga degët e saj në rrethe dhe ish-pronarët e truallit, brenda 25 ditëve nga data e fundit e publikimit dhe mbyllja e kërkesave, bën sistemimin e tij dhe kryen llogaritjet për pjesët e kapitalit të shoqërisë që përbëjnë paketat e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit.

2. Në përfundim të llogaritjeve Agjencia Kombëtare e Privatizimit nxjerr:

- rezultatin e kërkesës për aksione të shoqërisë për secilin punonjës dhe për çdo anëtar të familjes së tyre, në këmbim të bonove të privatizimit.
- rezultatin e porositjes së aksioneve të shoqërisë për ish-pronarët e truallit.
- rezultatin përfundimtar të llogaritjeve për pjesën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që përbën paketën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë e për ish-pronarët e truallit, të cilin ia dërgon Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

1. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda 10 ditëve pas marrjes së rezultatit përfundimtar nga AKP-ja, përcakton formulën e privatizimit, nxjerr urdhërin përkatës dhe e përcjell në AKP.

2. Në çdo rast, pjesë e urdhërit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit janë edhe të dhënat për shitjen e paketës së aksioneve, në përqindje, vlera nominale e paketës së aksioneve, numri i aksioneve që shiten dhe mënyra e pagesës së vlerës së paketës së aksioneve.

3. Në përcaktimin e paketës së aksioneve shtetërore Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit kërkon mendimin e organit të varësisë administrative.

4. Në qoftë se procedurat e llogaritjes së aksioneve të punonjësve të shoqërisë dhe të ish-pronarëve të truallit nuk realizohet, atëhere ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizmit nxjerr urdhërin për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë, pa u mohuar atyre të drejtën për aksione me një publikim të dytë.

5. Në shoqëritë tregtare, kur ka të dhëna të plota për pjesën e aksioneve për punonjësit e

shoqërisë dhe për ish-pronarët e truallit, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë paketën e aksioneve, që i ofrohet blerësit dhe nxjerr urdhërin përkatës për privatizim.

II. Procedurat për privatizimin e paketave të aksioneve

1. Brenda 10 ditëve nga marrja e urdhërit të ministrit (pika 3 e shkronjës "D", kapitulli I) Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon procedurën e publikimit për shitjen e paketës së aksioneve që i ofrohet blerësit, duke publikuar shitjen e paketës së aksioneve. Afati i publikimit do të jetë 30 ditë. Brenda kësaj periudhe bëhet publikimi në tri gazeta me qarkullim kombëtar.

Brenda periudhës së publikimit në gazetat me qarkullim kombëtar, Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos pranë shoqërive afishe, me të dhënat e publikuara për shoqëritë që privatizohen.

Në fund të periudhës së publikimit Agjencia Kombëtare e Privatizimit mban provesverbal për vendosjen pranë shoqërive të afisheve me të dhënat e publikuara.

Objekt publikimi do të jenë:

- Emri i shoqërisë;
- Selia;
- Kapitali themeltar dhe numri i aksioneve të shoqërisë;
- Paketa e aksioneve që privatizohen;
- Vlera e paketës së aksioneve;
- Objekti i veprimtarisë;
- Sipërfaqja e truallit të shoqërisë;
- Data, ora dhe vendi i zhvillimit të ankandit.

2. Pjesëmarrësit në ankand, gjatë periudhës së publikimit, kanë të drejtë të njihen me dosjen e shoqërisë, e cila ndodhet në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit. Gjithashtu ata mund të marrin informacion në shoqërinë që privatizohen. Pjesëmarrja në ankand, pa u njohur me dosjen e shoqërisë, është në përgjegjësinë e subjekteve pjesëmarrëse.

A. Paketa e aksioneve që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm

1. Paketa e aksioneve, që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm, shitet në lekë.

2. Pjesëmarrësit në ankandin e paketës së aksioneve, të ofruar blerësit të vetëm për privatizim, paraqesin para komisionit të ankandit dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesën me shkrim për pjesëmarrje në privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë.
- Dokumentet ligjore, identifikuese të personave fizikë ose juridikë.
- Dokumentin bankar të pagesës paraprake me lekë mandatarkëtimin, urdhërxhirimin apo garancinë bankare në lekë për 30 përqindshin e vlerës së paketës së aksioneve, në favor të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

3. Komisioni i ankandit përbëhet nga:

1. Përfaqësuesi i AKP-së	- kryetar
2. Juristi i AKP-së	- anëtar
3. Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	- anëtar
4. Përfaqësuesi i shoqërisë tregtare që privatizohet	- anëtar
5. Përfaqësuesi i organit administrativ të linjës	- anëtar
6. Punonjësi i AKP-së, pa të drejtë vote	- sekretar

4. Titullarët e organeve të përmendura në pikën 3 të shkronjës A, në kapitullin II të këtij vendimi, ngarkohen me përgjegjësi për mospjesëmarrjen e anëtarëve të komisionit të ankandit në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e ankandit.

5. Komisioni i ankandit merr vendime të vlefshme me votat e jo më pak se tre anëtarëve të vet. Kur nuk sigurohet pjesëmarrrja e plotë e anëtarëve të komisionit, ankandi zhvillohet, por jo me më pak se tre anëtarë komisioni, me të drejtë vote. Në këtë rast vendimi i anëtarëve të komisionit duhet të jetë unanim. Kryetari ka të drejtën e dy votave, në rast barazimi votash.

6. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të regjistrojë dhe të identifikojë, sipas dokumenteve që kërkon ligji, dhe të nënshkruajë me secilin pjesëmarrës marrëveshjen për kushtet për privatizimin e paketës së aksioneve.

- Të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit;
- Të deklarojë vlerën fillestare të ankandit;
- Të drejtojë marrjen e ofertave;
- Të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, që përbëhet nga procesverbali dhe raporti për përfundimin e ankandit. Ky dokumentacion nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të ankandit dhe nga fituesi i tij.

7. Fitues i ankandit shpallet deklaruesi i çmimit më të lartë.

8. Ditën e ankandit fituesi merr nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit autorizimin për pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve të publikuara për shitje, ku përcaktohen kushtet që duhen plotësuar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës së shitjes. Në të përcaktohet se fituesi i ankandit është i detyruar të bëjë pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

9. Pas lidhjes së kontratës pjesëmarrësve të tjerë u kthehet vlera fillestare, prej 30 përqindësh, e paguar paraprakisht për pjesëmarrje në ankand.

10. Fituesit të ankandit, që nuk kryen pagesën e plotë brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij kapitulli, si dhe rastet kur ai tërhiqet brenda këtij afati, i mbahet vlera fillestare, e paguar paraprakisht për pjesëmarrje në ankand, si e ardhur në buxhet. Në vazhdim, procedura rifillon nga pika 1 e kapitullit II të këtij vendimi.

11. Vetëm kur blerësi plotëson kushtet e autorizimit sipas pikës 8, kapitulli II-a, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh, me palën blerëse, kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të shoqërisë së publikuar për shitje.

12. Në rast se në ankandin e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës, kjo agjenci njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe pret një urdhër të ri nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për mënyrën e privatizimit të paketës së aksioneve.

B. Paketa e aksioneve për publikun

1. Shitja e paketës së aksioneve për publikun kryhet me ankand, me bono privatizimi dhe lekë privatizimi.

2. Procedurat e shitjes së paketës së aksioneve për publikun fillojnë me publikimin në tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën gjashtë herë. Brenda periudhës së publikimit në gazetat me qarkullim kombëtar, Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos afishe, me të dhënat e publikuara, në selinë e shoqërisë që privatizohet. Afati i publikimit zgjat jo më pak se 30 ditë.

3. Regjistrimi i porosive për aksione të shoqërisë, me bono dhe lekë privatizimi, zgjat jo më shumë se 45 ditë.

4. Personat, fizikë dhe juridikë, kanë të drejtë të porositin aksione për çdo shoqëri tregtare, të shpallur për shitje, njëkohësisht në të gjitha qendrat e ankandeve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe, pavarësisht nga vendndodhja e shoqërisë tregtare.

5. Të paktën brenda 45 ditëve nga data e mbylljes së ankandit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit përpunon dhe nxjerr rezultatin përfundimtar për secilin pjesëmarrës në ankand. Mënyra e shpërndarjes së kapitalit të paketës së aksioneve për publikun do të jetë në përpjesëtim, sipas rezultateve përfundimtare të raportit kërkesë-ofertë.

6. Përfundimi i periudhës së regjistrimit shënon edhe përfundimin e privatizimit të paketës së aksioneve për publikun.

C. Privatizimi i paketës së aksioneve shtetërore në shoqëritë pjesërisht të privatizuara

1. Në shoqëritë, ku paketa shtetërore është nën 50 për qind të aksioneve, në bazë të dokumentacionit që ka AKP-ja, pasi të jetë zbritur përqindja e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, shitja e pjesës së mbetur të paketës së aksioneve, në favor të aksionerëve të shoqërisë, bëhet me përcaktimin e vlerës së tregut të paketës së aksioneve me ankand.

2. Me mbërritjen e urdhrit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i cili shoqërohet edhe nga lista e aksionerëve të shoqërisë, me adresat përkatëse. Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon dhe zbaton procedurat e privatizimit, sipas pikave 1,2 të kapitullit II, dhe sipas pikave 1,2,3,4,5,6 të shkronjës A të këtij vendimi.

3. Ofertë fituese shpallet oferta që deklaron çmimin më të lartë. Kjo ofertë, brenda 10 ditëve, i

ofrohet aksionerëve të shoqërisë, të cilët duhet të japin pëlqimin për blerje, të shoqëruar me pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve, të arritur në ankandin e zhvilluar. Pagesa duhet të bëhet brenda 40 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

4. Kur aksionerët e shoqërisë, të cilëve u është ofruar për blerje paketa e aksioneve, nuk japin pëlqimin për blerje dhe nuk kryejnë pagesën përkatëse brenda 10 ditëve, atëhere njoftohet pjesëmarrësi që ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve në ankandin e zhvilluar, duke lëshuar autorizimin përkatës për pagesën e vlerës së plotë të paketës së aksioneve.

Kjo pagesë duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

5. Kur pjesëmarrësi në ankand, i cili ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve, nuk kryen pagesën sipas paragrafit të dytë të pikës 4, të shkronjës "C", atëhere vlera prej 30 përqindësh, e paguar paraprakisht prej tij, mbahet si e ardhur në buxhet.

6. Në këtë rast, pjesa e mbetur e paketës së aksioneve u ofrohet pjesëmarrësve në ankand sipas radhës. Kur nuk ka oferta të tjera, atëhere ajo u ofrohet aksionerëve të shoqërisë pa ankand.

7. Brenda 5 ditëve nga mbërritja e urdhërit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit fton aksionerët e shoqërisë të paraqiten për fillimin e procedurave të privatizimit. Aksionerët e shoqërisë duhet të paraqiten në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

8. Kur aksionerët e shoqërisë nuk paraqiten brenda këtij afati ose nuk pranojnë blerjen e paketës, Agjencia Kombëtare e Privatizimit njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe pret urdhrin përkatës të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për mënyrën e privatizimit të pjesës së mbetur të aksioneve në shoqërinë përkatëse.

9. Aksionerët e shoqërisë, për fillimin e procedurave të privatizimit, duhet të paraqesin në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit këto dokumente:

a. Kërkesën me shkrim, ku të shprehin pëlqimin për blerjen e pjesës së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje;

b. Pagesën paraprake, mandatarkëtimin, urdhërxhirimin apo garancinë bankare në lekë për 30 përqindëshin e vlerës së pjesës së mbetur të aksioneve, që u janë ofruar për blerje, në favor të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;

c. Një fotokopje të noterizuar të dokumentit identifikues.

Kur aksionerët e shoqërisë kanë plotësuar kërkesat e mësipërme, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lëshon autorizimin për kryerjen e pagesës së plotë të vlerës së pjesë së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje.

Në autorizim përcaktohet se nëse aksionerët e shoqërisë nuk bëjnë pagesën e plotë të pjesës së mbetur të vlerës së aksioneve që u janë ofruar për blerje brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të autorizimit, atëhere mbahet vlera e paguar paraprakisht prej tyre, 30 për qind, e cila kalon në favor të buxhetit të shtetit. Për llogari të AKP-së kalon 5 për qind e vlerës së plotë të pjesës së mbetur të aksioneve, që përcaktohet në urdhërin përkatës të ministrit të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Edhe në rastet kur nuk kryhet pagesa e plotë nga aksionerët e shoqërisë, në favor të AKP-së kalon vlera prej 5 përqindësh nga vlera 30 për qind e paguar paraprakisht prej tyre.

Për shoqëritë pjesërisht të privatizuara, kapitali i të cilave gjatë kësaj kohe ka pësuar ndryshime, llogaritja e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit do të bëhen duke iu referuar kapitalit themeltar, të regjistruar në gjykatë, me të cilin ka filluar procedura e privatizimit të shoqërisë.

III. Të përgjithshme

1. Rezultatet përfundimtare, të ankandit hartohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit në katër kopje, tre prej të cilave u përcillen:

- Shoqërisë tregtare të privatizuar;
- Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
- Qendrës së regjistrimit të aksioneve.
- Kopja e katërt ruhet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit

2. Vlera e llogaritur e një aksioni caktohet e tillë që të zvogëlojë, në minimumin e mundshëm, efektet e rrumbullakimeve të përqindjeve. Mbetjet e mundshme nga rrumbullakimet kalojnë në

llogaritë e shoqërisë, në zmadhim ose në zvogëlim të rezervës nga rivlerësimi.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit harton raportin përfundimtar për strukturën e pronësisë së aksioneve dhe materialin origjinal e dërgon në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Lista e aksionerëve nuk publikohet. Çdo aksioner ka të drejtë të njihet me këtë listë pranë shoqërisë përkatëse dhe në rast paqartësie, mund të kërkojë sqarime pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

5. Gjatë periudhës pas ankandit deri në mbledhjen e parë të asamblesë është i ndaluar çdo emëtim dytësor i aksioneve nga ana e shoqërisë.

6. Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet asnjë strukturim i kapitalit ekzistues.

7. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe kryerjes së ndryshimeve përkatëse të statutit, këshilli mbikëqyrës dhe drejtori i përgjithshëm i shoqërisë shtetëtore do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi të plotë për administrimin e pasurisë e të veprimtarisë së shoqërisë.

8. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe hyrjen në funksion të këtyre organeve, as shoqëria dhe as ndonjë organ tjetër nuk kanë të drejtë të kryejnë ose të autorizojnë kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

- Shitjen e aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë;
- Kryerjen e investimeve të tjera, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë;
- Marrjen ose dhënien me qira të objekteve të ndryshme;
- Marrjen e huave, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë, për nevoja rrjedhëse të veprimtarisë së shoqërisë;
- Çdo veprim tjetër, që do të sillte pakësimin e aktivit neto të shoqërisë.
- Gjatë kësaj periudhe shoqëria nuk ka të drejtë, gjithashtu, të kryejë riorganizime, që sjellin shkurtime në numrin e punonjësve.

9. Shoqëria përgatit gjendjen financiare, për periudhën nga çelja e ushtrimit deri në datën e fundit të muajit kur është shpallur rezultati përfundimtar i ankandit, sipas akteve ligjore në fuqi.

10. Shoqëria shtetërore e privatizuar do të vazhdojë të mbartë të gjitha detyrimet, kreditore dhe debitore, të pasqyruara në bilancin e paraqitur të shoqërisë.

11. Procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të asamblesë së shoqërive anonime u duhen referuar ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare".

12. Shoqëritë anonime, të krijuara me kapital të përbashkët, do të trajtohen sipas vendimit nr.230, datë 4.4.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruar nga shteti, në shoqëritë me kapital të përbashkët".

13. Vendimet nr.244, datë 25.5.1995, nr.608, datë 30.10.1995, nr.759, datë 11.11.1996, nr.760, datë 11.11.1996, nr.837, datë 9.12.1996, nr.446, datë 9.7.1998, nr.486, datë 28.10.1999, nr.24, datë 21.1.1999, nr.328, datë 12.7.1999, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Për aktet ligjore e nënligjore, ku gjejnë zbatim vendimet e mësipërme, zbatohet ky vendim.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 122, datë 18.3.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.529, DATË 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË ZOTËROHET NGA SHTETI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23, të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private të

pavarura dhe privatizimit", dhe të pikës 2 të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.Pika 2 në kapitullin I, ndryshohet si më poshtë:

"Vendimi i Këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të paketave të aksioneve përcakton:

- formën e tenderit (të hapur ose të kufizuar). Në rastin e tenderit të kufizuar edhe emrat e kandidatëve, që ftohen të marrin pjesë.
- vlerën e depozitës së garancisë për pjesëmarrjen në tender, e cila caktohet në varësi të kërkesave të tenderit dhe të veprimtarisë së shoqërisë që privatizohet. Depozita e garancisë të jetë deri në 15 për qind të vlerës nominale të paketës së aksioneve, që ofrohen për shitje, por jo më e vogël se 30 000 (tridhjetë mijë) USD.
- trajtimin e dokumentacionit të tenderit në formë konfidenciale ose jo".

2. Pika 1, në kapitullin II, ndryshohet si më poshtë:

"Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, për privatizimin me tender të paketave të aksioneve, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumentacionit për privatizimin me tender të shoqërisë.

3. Pika 1, në kapitullin II.1, riformulohet si më poshtë:

"Ftesa për tender publikohet në tri gazeta me qarkullim kombëtar, jo më pak se tri herë në secilën gazetë, brenda një afati 30 ditësh. Gjatë kësaj periudhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos afishe pranë shoqërisë përkatëse.".

4. Shkronja "f" e pikës 4, në kapitullin II. 1, ndryshohet si më poshtë:

"Pagesën për tërheqjen e dokumentacionit të tenderit, pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në këmbim të një deklarate me shkrim për trajtimin, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për konfidencialitetin.".

5. Pas shkronjës "h", të pikës 4, në kapitullin II.1, shtohet shkronja "i", me këtë përmbajtje:

"Projektkontrata për shitjen e paketës së aksioneve me tender.".

6. Pika 1, në kapitullin IV, riformulohet si më poshtë:

"Në ditën dhe vendin e caktuar në ftesën për tender, kandidatët do t'i paraqesin ofertat (në pesë kopje) me zarf të mbyllur, të vulosur, pa emrin e kandidatit. Çdo faqe e 5 kopjeve të ofertës duhet të ketë firmën origjinale të kandidatit (ose të autorizuar prej tij).

Dokumentacioni i paraqitur në ofertë duhet të jetë në gjuhën shqipe, ndërsa për investitorët e huaj edhe në anglisht.".

7. Paragrafi i fundit i pikës 3, në kapitullin IV, riformulohet si më poshtë:

"Pagimin e çmimit të paraqitur në ofertë, sipas kontratës me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.".

8. Pika 1, në kapitullin VI, shfuqizohet.

9. Në pikën 3, në kapitullin VII, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Eksperti, i kërkuar prej komisionit të vlerësimit të ofertave, shpërblehet sipas përcaktimit të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në varësi të detyrave që i caktohen.".

10. Në fjalinë e fundit të pikës 1, në kapitulllin VIII, pas "…por vetëm", hiqet fjala "kryesisht".

11. Shkronja "b", e pikës 1, në kapitullin IX, riformulohet si më poshtë:

"Kandidati në tender ka shkelur konfidencialitetin, kur ai kërkohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.".

12. Paragrafi i dytë i pikës 2, në kapitullin IX, riformulohet si më poshtë:

"Nuk paraqitet ndonjë ofertë në kohën dhe vendin e caktuar në ftesën për tender.".

13. Pika 3, në kapitullin X, riformulohet si më poshtë:

"Në vendimin e rezultatit të tenderit shënohet klasifikimi i kandidatëve, sipas rendit zbritës.".

14. Në kapitullin X shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

"6. Pas shpalljes me vendim të Këshillit të Ministrave të fituesit, Agjencia Kombëtare e

Privatizimit lëshon autorizimin për pjesëmarrësit e tjerë, që të tërheqin depozitën e garancisë.”.

15. Pika 2, në kapitullin XI, rifomulohet si më poshtë:

“Elementët e kontratës për shitjen e paketës së aksioneve me tender do të përmbajnë të gjitha kërkesat e ftesës për tender dhe penalitetet përkatëse.”.

16. Në pikën 3, në kapitullin XI, bëhet ky ndryshim:

Nga “brenda 15 ditëve”, në “brenda 60 ditëve”.

17. Pas pikës 3, në kapitullin XI, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Brenda 2 ditëve pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e fituesit të tenderit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon negocimin me fituesin e tenderit, për kontratën e shitjes së paketës së aksioneve.”.

18. Shkronja “a” e pikës 4, në kapitullin XI, ndryshohet si më poshtë:

“nuk nënshkruhet, sepse palët nuk bien dakord.”.

19. Shkronja “d” e pikës 4, në kapitullin XI, ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia Kombëtare e Privatizimit negocion për nënshkrimin e kontratës me kandidatin e radhës, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe pas hyrjes së vendimit në fuqi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 123, datë 18.3.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 463, DATË 6.10.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E TENDERIT SI FORMË TË PRIVATIZIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, dhe të pikave 1 dhe 2, të kapitullit I, të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet:

“Kriteret bazë të vlerësimit të ofertave do të jenë sipas pikave të mëposhtme:

a) Çmim i ofruar	30
b) Investimi që do të kryhet	30
c) Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit	15
ç) Cilësia e investitorit	15

Kjo cilësi gjykohet sipas dokumentacionit të paraqitur në ofertë:

- Aktit të regjistrimit ose të ekuivalentit me të, të çertifikuar jo më pak se 30 ditë nga data e paraqitjes së tij.
- Bilancit kontabël, të audituar të paktën për tri vitet e fundit;
- Raportit të auditorëve të huaj për tri vitet e fundit;
- Përmbledhëses së veprimtarive kryesore (duke përcaktuar veprimtaritë) dhe përvojës në veprimtari të tilla në Europën Qendrore ose Lindore dhe në Shqipëri. Pjesëmarrja në privatizime, në këto vende:
- Të ketë reputacion dhe përvojë të drejtpërdrejtë në prodhimin përkatës, jo më pak se 5 vjet;

d) Tregues për punësimin dhe planet për ritrajnimet10.”.

2. Pika 3 ndryshohet:

“Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhërin për fillimin e procedurës së privatizimit me tender të shoqërive.”.

3. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Depozita e garancisë së tenderit do të jetë një vlerë fikse prej 30 000 (tridhjetë mijë) USD-sh.”.

4. Pas pikës 3/1, shtohet pika 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/2. Dokumentacioni do të jetë i disponueshëm për t’u bërë i njohur nga çdo i interesuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 126, datë 23.3.2000

PËR PËRBËRJEN DHE PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR SHPRONËSIMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr.8561, datë 25.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, krijohet me urdhër të ministrit që mbulon veprimtarinë në objektin për të cilin paraqitet kërkesa për shpronësim dhe përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë. Kryetari i komisionit të posaçëm caktohet zëvendësministri i ministrisë përkatëse.

2. Në komision përfshihen, sipas përkatësisë, nëpunës ose specialistë të pavarur, me përvojë dhe kualifikim të posaçëm për vlerësimin e objektit që shpronësohet, të tillë si ekonomistë, juristë, inxhinierë e agronomë, të cilët nnuk kanë asnjë lidhje farefisnore me pronarët dhe nuk janë palë të interesuara në pronat që shpronësohen.

3. Gjatë veprimtarisë komisioni i posaçëm ndjek këtë procedurë pune:

- Studion dhe verifikon kërkesën e paraqitur nga subjekti i interesuar për shpronësim për interesa publike dhe, në rast se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose i saktë, komisioni e kthen për plotësim, duke caktuar edhe afat për plotësimet përkatëse. Për rastet kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetura, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit, kërkesa hidhet poshtë, gjë që i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit.
- Kur vërteton se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues janë në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore, përkatëse, komisioni vendos për pranimin e kërkesës për shpronësim dhe njofton menjëherë, me shkrim, subjektin kërkues, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, dhe lidh marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta për procedurën e shpronësimit, e cila është titull ekzekutiv.
- Njofton drejtpërdrejtë, brenda 10 ditësh nga data e lidhjes së marrëveshjes, secilin pronar a bashkëpronar të pasurive pronë private, që kërkohen të shpronësohen ose zhvlerësohen si dhe personat e tretë, për shpronësimin e tyre. Njoftimi bëhet në mbështetje të dispozitave, të vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullojnë procedurën e njoftimit për shpronësim.
- Bën publikimin e kërkesës për shpronësim për interes publik.
- Kryen veprime për identifikimin dhe vlerësimin përfundimtar, si dhe bën përllogaritjen e masës së shpërblimit për objektet që shpronësohen. Vlerësimi i pasurive pronë private, që

shpronësohen, zhvlerësohen apo shpërblehen, bëhet në bazë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave për kriteret e vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive të mësipërme.

- Përgatit propozimin për shpronësim, së bashku me dokumentacionin, sipas nenit 20 të ligjit përkatës për shpronësimet, i cili i paraqitet Këshillit të Ministrave nga ministri përkatës.

- Në rast kundërshtimi të shpronësimit, nga Këshilli i Ministrave përgatitet dokumentacioni për kthimin e fondeve të depozituara për procedurën e shpronësimit.

4. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit të posaçëm caktohet me urdhër të ministrit që krijon këtë komision.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 127, datë 23.3.2000

PËR PËRMBAJTJEN DHE PROCEDURAT E PARAQITJES SË KËRKESËS DHE TË NJOFTIMIT PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË PRONË PRIVATE PËR INTERES PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 14, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private me interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet, standarde, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njoftimi për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik bëhet në bazë të formularit nr.2, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Njoftimi duhet të përmbajë objektin që ndërtohet, adresën e kërkuesit, objektin që shpronësohet, adresën e objektit që shpronësohet, listën emërore të të shpronësuarit, specifikimet e objektit që shpronësohet (zonën, qytetin, objektin, sipërfaqen, vëllimin), afatin, brenda të cilit duhet të fillojë shpronësimi, si dhe kërkuesin. Njoftimit i bashkëlidhet edhe raporti i specialistëve për gjendjen fizike të objektit, që shpronësohet apo merret në përdorim të përkohshëm.

4. Njoftimi me shkrim konsiderohet i marrë, në rast se i është dorëzuar personalisht marrësit ose në rast se është dorëzuar në selinë, vendbanimin ose në adresën postare të tij; nëse nga shqyrtimi i mundshëm i rrethanave nuk vërtetohet asnjëra prej këtyre rasteve, njoftimi me shkrim quhet i marrë po të jetë dërgur me letër rekomande ose me çdo mjet tjetër, ku regjistrohet vullneti për dorëzimin e njoftimit në adresën e fundit të ditur të selisë, të banesës ose në adresën postare.

Në qoftë se personi i interesuar refuzon të marrë në dorëzim njoftimin, atëherë personi i ngarkuar për bërjen e njoftimit bën shënimin përkatës në njoftim dhe, kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e dy dëshmitarëve të pranishëm.

5. Njoftimi quhet i marrë në ditën e dorëzimit të tij.

6. Kur i interesuari nuk ka vendbanim, vendqendrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë ose nuk ka zgjedhur një banesë a nuk ka caktuar një përfaqësues, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në lagjen ose komunën e vendit ku ndodhet objekti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Objekti që do të shpronësohet _____

Ministrisë _____

Kërkuesi _____

Adresa e kërkuesit _____

Dokumenta që vërtetojnë gjendjen juridike të kërkuesit.

Projektet e miratuara në institucionet përkatëse.

Argumentimi ligjor për interesin publik të shpronësimit dhe shkaku për të cilin bëhet ky shpronësim.

Dokument financiar për garantimin e fondeve për realizimin e projektit, shpronësimit dhe atë të zhvlerësimit.

Masa e shpërblimit të parashikuar për secilin pronar.

Autorizimet dhe lejet e miratuara nga organet kompetente për realizimin e projektit.

Afatet dhe mënyrat e realizimit të projektit nga vetë kërkuesi ose me të tretë.

Lista të pronarëve të pasurive pronë private.

Lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit.

Lista e personave të tretë që duhen të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që do të shpronësohet.

Për tre pikat e mësipërme të paraqiten shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, parashikimet për vlerësimin e pasurive dhe të drejtave, adresat dhe vendbanimet më të fundit të njohur të pronarëve dhe personave të tretë përkatës.

Hartë treguese në shkallën 1:1000 ose 1:2500

Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të konfirmojë listat e pronarëve brenda 10 ditëve

Hartë treguese në qendrat e banuara në shkallëm 1:500

Kërkuesi
(.....)

NJOFTIM PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Të shpronësuarit Z._____

Adresa _____

Adresa e objektit që do të shpronësohet _____

Si rezultat i ndërtimit të objektit _____

_____objekt shpronësimi në bazë të nenit _____, të Ligjit Nr.8561, dt. 11.01.2000 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", rezulton që sipas dokumentit të pronësisë ju jeni pronari/bashkëpronarë i/ të ligjshëm të objektit _____me të dhënat e mëposhtme:

- Zonë kadastrale sipas hartës së regjistrimit
- Qyteti (adresa)
- Objekti (emërtimi)
- Sipëfaqja në m2
- Volumi në m3

për të cilën kërkuesit _____brenda një afati prej_____muaj/ditë i nevojitet për realizimin e ndërtimit të objektit_____.

Bashkëlidhur keni raportin e vlerësimit përfundimtar të mbajtur nga komisioni i posaçëm për shpronësim ngritur me urdhër të Ministrit Nr._____, dt._____i cili procedon në bazë të V.K.M. Nr._____dt. _____ në lidhje me:

- masën e shpërblimit si pronar i shpronësuar në lekë/dollarë
- masën e shpërblimit si pronar i pasurisë së zhvleftësuar në lekë/dollarë

- masën e shpërblimit për kompensim si person i tretë për të drejtat për shkak të shpronësimit në lekë/dollarë

Në lidhje me vlerësimin e objektit që do të shpronësohet keni të drejtë që brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të paraqitni pretendimet tuaja në Ministrinë kompetente

Organi kompetent
Ministria_____.

VENDIM
Nr.138, datë 23.3.2000

PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE TË PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN, TË PASURIVE QË ZHVLERËSOHEN DHE TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRETË, PËR INTERES PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 18, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vlerësimi për truallin të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve që ka zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP).

Mesatarja e shitblerjeve të përcaktohet bazuar në rajonin e interesuar ku realizohet shpronësimi për interes publik.

Periudha kohore e llogaritjes së mesatares të mos rezultojë më e largët se 3 mujori paraardhës, duke filluar nga data që bëhet kërkesa.

ZRPP-ja detyrohet që deklarimin e mesatares së shitblerjes ta realizojë brenda 5 ditëve nga paraqitja zyrtare e kërkesës, prej subjekteve të interesuar për shpronësim për interes publik.

Dokumenti që lëshohet nga ZRPP-ja përbën akt zyrtar, i cili formulohet me shkrim dhe firmoset nga përgjegjësi i ZRPP-së. Kopja e tij ruhet pranë ZRPP-së.

Në rastet kur në rajonin e interesuar për shpronësime për interesa publike mungojnë treguesit e shitblerjes, vlerësimi të përcaktohet me metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë, me shitblerjet e rajoneve të tjera, sipas kritereve të mëposhtëm:

a) Të vendndodhjes së pronës (klasifikuar sipas vendimit nr.722, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së urbanistikës").

- turistike;
- urbane;
- suburbane;
- rurale.

b) Të përshtatshmërisë inxhinierike të truallit për të mbajtur struktura ndërtimore.

2. Vlerësimi për objektet e banimit të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, përcaktuar nga ZRPP-ja, sipas procedurës për rastin e truallit.

- Në rastet kur mungojnë treguesit e shitblerjeve, vlerësimi të përcaktohet me metodën e kostos së ndërtimit, duke përdorur si bazë çmimet e Entit Kombëtar të Banesave.

3. Vlerësimi për objektet e ndërtimit, industriale, bujqësore etj., të përcaktohet me metodën e kostos së ndërtimit nga ministritë përkatëse dhe konkretisht:

- çmimet të merren si mesatare e tregut;
- vlerësimit t'i zbritet amortizimi.

4. Vlerësimi të bëhet sipas formularit nr.1, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Vlerësimi për tokën bujqësore, bimëve drufrutore, pyjeve, kullotave, livadheve, tokave

pyjore dhe fidanishteve të përhershme, të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve që ka ZRPP-ja, në përputhje me procedurën për rastin e truallit.

Në rastet kur mungojnë treguesit e shitblerjeve, të deklaruara me shkrim nga ZRPP-ja, subjektet e interesuar për shpronësim kërkojnë, pranë strukturave të ministrisë përkatëse, vlerësimin teknik dhe përllogaritjen e shpërblimit të pronës private, që kërkohet të shpronësohet.

Kritere të vlerësimit teknik të përllogaritjes së shpërblimit të pasurive pronë private do të merren:

- Për tokën bujqësore (në kuptim të vlerësimit si faktor prodhimi, lidhur me pjellorinë natyrale), pa bimësinë e kultivuar:

a) Kategoria e tokës, sipas bonitetit që kanë drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit.

b) Qenia nën ujë ose mbi ujë, ujitja, që përcaktohet nga drejtoria e ujërave, në kuadër të sistemit të ujitjes për zonën.

c) Largësia nga qendra urbane, që përcaktohet sipas "Rregullores së urbanistikës".

- Për bimët dru-frutore vlerësimi do të bëhet me metodën e kostos (investimi i kryer dhe shpenzimet ushtrimore). Vlerësimi realizohet për rrënjë (në pemë frutore, ullinj, agrume, pjergulla dhe ereke), për njësi sipërfaqeje (m2, dynym, ha) për vreshta, fidanishte dhe luleshtrydhe.

Në vlerësim merren për bazë investimet faktike, të realizuara, si dhe tërësia e shpenzimeve, duke reflektuar vlerat e amortizimit vjetor, të amortizimit shëndetësor dhe tregues të tjerë, që përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe ushqimit.

- Për bimët e arave vlerësimi të kryhet në bazë të prodhimit të pritshëm, të vlerësuar me çmimet e tregut.

Kriteret e vlerësimit për pyjet, livadhet, kullotat dhe tokat bujqësore të jenë si më poshtë:

a) Boniteti i tokave pyjore dhe kullosore, pyjeve dhe livadheve, si dhe kapaciteti mbajtës i kullotave dhe i livadheve.

b) Vlera mjedisore, ekologjike dhe funksioni i tokës pyjore dhe kullosore (prodhues, mbrojtës, turistik, zonë e mbrojtur, etj.).

c) Vendndodhja gjeografike (zonë bregdetare, kodrinore e malore) dhe afërsia apo largësia nga qendrat e banuara, në varësi të funksionit.

ç) Vlera e materialit drusor e jodrusor, bimëve mjekësore, eterovajore, tanifere dhe faunës së egër.

d) Niveli i investimeve dhe infrastrukturës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 145, datë 31.3.2000

PËR RIORGANIZIMIN E QENDRAVE STUDENTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, pika 1, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e qendrave studentore në Tiranë, për rritjen e efektivitetit dhe të kontrollit.

2. Krijimin e drejtorisë së përgjithshme të qendrave studentore në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Kjo drejtori e përgjithshme të ketë në përbërjen e vet:

a. Ndërmarrjen e Trajtimit të Studentëve nr.1 (NTS 1);

b. Ndërmarrjen e konvikteve dhe të mensave nr.2, e cila riemërtohet Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.2 (NTS 2);

c. Ndërmarrjen tregtare të trajtimit të studentëve, nr.3, e cila riemërtohet Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.3 (NTS 3);

ç. Ndërmarrjen e elektrik-ujësjellësit të mjediseve studentore (NEUMS);

d. Kinoklubin e qytetit Studenti;

dh. Bibliotekën e Qytetit Studenti;

e. Ndërmarrjen e pastrim-gjelbërimit.

4. Ndërmarrjet e mësipërme, në përbërje të drejtorisë së përgjithshme të qendrave studentore, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në konvikte e mensa, për pastrim gjelbërimin dhe për ngrohjen e mjediseve studentore.

5. Për realizimin e funksioneve dhe detyrimeve, të përcaktuara në këtë vendim, në planin e buxhetit të vitit 2000, të bëhen pakësimet e mëposhtme nga ministritë si vijon, dhe të shtohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

Ministrisë së Punëve Publike

Fond page	13 850 mijë lekë
Sigurime shoqërore	4 035 mijë lekë
Numri i punonjësve	112

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Fond page	670 mijë lekë
Sigurime shoqërore	195 mijë lekë
Numri i punonjësve	7

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

7. Pika 1,2,5 dhe 6, të vendimit nr.214, datë 15.7.1991, të Këshillit të Ministrave, "Për shkëputjen e veprimtarisë jetësore të studentëve nga drejtimi i shkollave të larta" dhe vendimi nr.395, datë 12.8.1999, i Këshillit të Ministrave, "Për riorganizimin e qendrave studentore" shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 147, datë 31.3.2000

PËR RREGULLAT DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR SHPRONËSIMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i posaçëm për shpronësimet, krijohet me urdhër të ministrit dhe ushtron veprimtarinë që nga çasti i krijimit të tij deri në përfundim të procesit të dhënies a vënies në dispozicion të shpërblimit të shpronësimit në favor të të shpronësuarit.

2. Mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet thirren dhe drejtohen nga kryetari.

3. Përcaktimi i rendit dhe i datës së zhvillimit të mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari i komisionit, i cili kujdeset për shpërndarjen e materialit, si rregull të paktën tre ditë përpara

asaj të caktuar për mbledhjen e tij.

4. Komisioni i posaçëm për shpronësimet mblidhet sa herë të jetë e nevojshme.

5. Mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 3/4 e anëtarëve të tij.

6. Në fillim të mbledhjes, kryetari i komisionit verifikon numrin e pjesëmarrësve dhe në mungesë të shumicës së nevojshme, vendos thirrjen e mbledhjes tjetër jo më vonë se dy ditë.

7. Në rastet e mospjesëmarrjes pa arsye të motivuar, krahas largimit nga komisioni, ndaj anëtarit të komisionit të posaçëm për shpronësimet, titullari përkatës jep masë disiplinore sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil".

8. Sipas vlerësimit të kryetarit të komisionit, në mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet thirren dhe janë të detyruar të marrin pjesë për shpjegime dhe sqarime të posaçme specialistët përkatës. Këta persona nuk kanë të drejtë vote.

9. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve sipas rendit të ditës, kryetari i komisionit të posaçëm të shpronësimit vendos hedhjen në votë të çështjeve për të cilët duhet të merren vendim nga komisioni.

10. Vendimet e komisionit të posaçëm për shpronësimet merren me shumicën e votave (shumicë absolute) të anëtarëve me të drejtë vote. Në rast barazie votash, vendos vota e kryetarit të komisionit.

11. Vendimet e komisionit të posaçëm për shpronësimet janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha strukturat dhe personat e ngarkuar posaçërisht nga përmbajtja e tij.

12. Vendimet e marra nga komisioni i posaçëm për shpronësimet i dërgohen menjëherë ministrit, i cili brenda 10 ditëve, për shkaqe ligjore dhe arsye të motivuara ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e çështjes nga komisioni.

13. Në ushtrimin e funksioneve të tij, komisioni i posaçëm për shpronësimet, ndihmohet nga një sekretari teknike. Kjo sekretari me aktin e krijimit të komisionit nga ministri, caktohet dhe operon në një nga strukturat e ministrisë.

14. Sekretaria teknike ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve dhe përgatitjen e materialeve që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit të posaçëm për shpronësimet si dhe të procesverbaleve të mbledhjes.

15. Sekretaria teknike kujdeset dhe përgjigjet për dërgimin dhe marrjen e të dhënave, të njoftimeve dhe të korrespondencës me organet, personat juridikë dhe fizikë lidhur me procedurën e shpronësimit.

16. Çështjet dhe procedurat që shqyrtohen nga komisioni i posaçëm për shpronësimet janë ato që parashikohen në ligjin nr.8561, datë 25.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", dhe vendimit nr.126, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen dhe procedurat e punës së komisionit të posaçëm të shpronësimit", të dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 148, datë 31.3.2000

PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE TË ARDHURA GRANT NGA JAPONIA NË KUADËR TË PROJEKTIT "SHTIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE", 2KR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shitja e mallrave të ardhura nga Japonia, nëpërmjet projektit "Shtimi i prodhimeve ushqimore", "2KR, bëhet nëpërmjet ankandit. Dokumentacioni dhe forma e ankandit përcaktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, në mbështetje të vendimit nr.192, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes".

Për mallrat që do të mbeten pa u shitur pas zhvillimit të dy ankandeve të njëpasnjëshëm, të aplikohet shitja me këste e mallrave përfituesve nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, nëpërmjet një linje kreditimi me interes zero. Si çmim i shitjes me këste të mallrave të aplikohet çmimi që do të rezultojë në përfundim të ankandit. Kriteret e tjera të përzgjedhjes së përfituesve dhe të shitjes së mallrave me këste përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe struktura e ngarkuar prej saj për zbatimin e projektit të bashkëpunojnë me sektorin privat, me agroserviset, me shoqatat e agrobiznesit, për projektet e tjera dhe përfituesit, për të garantuar shitjen e shpejtë të mallrave dhe krijimin, në afatin e parashikuar, të fondit kundërparti.

3. Struktura e shpenzimeve të domosdoshme për shitjen e mallrave të ardhura nëpërmjet projektit të sipërpërmendur dhe kthimin e fondit kundërparti përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për çdo vit, deri në përfundim të projektit të miratuar.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë udhëzimin e zbatimit të projektit "Shtimi i prodhimeve ushqimore", "2KR.

5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr.149, datë 31.3.2000

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË ZË REHABILITIMI I AKSIT RRUGOR DURRËS - RROGOZHINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 9, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për sipërfaqen: truall 11026 m2 dhe tokë bujqësore 134 746 m2, që zë rehabilitimi i aksit rrugor "Durrës-Rrogozhinë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 126 659 172 (njëqindenjëzetegjashtë milionë e gjashtëqindepesëdhjetenëntë mijë e njëqindeshtatëdhjetedy) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt në buxhetin e vitit 2000, të Ministrisë së Transportit, në zërin "Shpronësime".

5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit gusht të vitit 2000.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, bashkia e Kavajës, bashkia e Rrogozhinës dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 173, datë 13.4.2000

PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË NJË VËLLIMI ORIGJINAL, TË RESTAURUAR TË "CODEX BERATINUS PURPUREUS" (SHEKULLI VI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, pika 3, të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993, "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat ", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë pjesë në ekspozitën ndërkombëtare "Ungjijtë e popujve", në Vatikan, me një vëllim origjinal, të restauruar të "CODEX BERATINUS PURPUREUS" (shek VI.).

2. Kodiku të qëndrojë i ekspozuar dy muaj.

3. Kushtet dhe kërkesat për sigurimin, gjatë transportit, të Kodikut dhe koha e ekspozimit të përcaktohen në kontratën e nënshkruar ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Bibliotekës Apostolike të Vatikanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 179, datë 13.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.529, DATE 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE QË ZOTËROHEN NGA SHTETI, TË SHOQËRIVE TREGTARE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.122, DATË 18.3.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit", dhe te paragrafit të dyte, të nenit 3, te ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojne në sektorët jostrategjikë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit i pikes 5, në kapitullin I, ndryshohet si më poshtë:

"Kur ka të dhëna të plota, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë madhësinë e paketës së aksioneve, që i ofrohet blerësit, si dhe nxjerr urdhërin përkatës për privatizimin me tender sipas këtij vendimi".

Procedurat e llogaritjes së saktë të madhësisë dhe shitjes së paketave të aksioneve për:

- publikun,

- ish-pronarët e truallit,
- punonjësit e shoqërisë

do të kryhen sipas kapitullit I, shkronjat “b”, “c”, “d”, të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”.

2. Pika 4 e kapitullit X, shfuqizohet

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 181, datë 13.4.2000

PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2000, TË MINISTRISË SË TRANSPORTIT, PËR RIVESHJEN PJESORE, NË RRUGËT TIRANË –NDROQ-PLEPA DHE VORË-DURRËS ME PROCEDURËN E PROKURIMIT TË DREJTPËRDREJTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7. 1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Transportit , në planin e buxhetit të vitit 2000, në zërin “Investime”, i shtohen 92 milionë lekë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të cilat do të përdoren si vijon:

- 27 milionë lekë për riveshjen pjesore të segmentit rrugor Tiranë –Ndroq-Plepa;
- 65 milionë lekë për riveshjen pjesore të segmentit rrugor Vorë-Durrës.

2. Autorizohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të prokurojë fondin e mësipërm, me procedurën e prokurimit të drejtëpërdrejtë, me “Albavia”, sh.p.k.

3. Fondi prej 92 milionë lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Punimet në këto segmente rrugore të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i““

Zija Vuci, Anëtar i“““
Hajredin Fuga, Anëtar i“““
Alfred Karamuço, Anëtar i“““
Kristofor Peçi, Anëtar i“““
Kujtim Puto, Anëtar i“““
Sokol Sadushi, Anëtar i“““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.11.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.58 Akti që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E LARTË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. PRESIDENTI I REPUBLIKËS, i përfaqësuar nga zoti Theodhori Sollaku, këshilltar ligjor.
2.KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.
3. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

O B J E K T I

Papajtueshmëria me Kushtetutën e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje.

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, në çështjen penale në ngarkim të të pandehurve Flamur Rako, Haxhi Idrizi dhe Abaz Taqe, duke u nisur nga fakti se gjykatat e instancave më të ulta ndaj njërit prej të pandehurve kanë aplikuar dënimin me vdekje për veprën penale të “vrasjes me dashje në lidhje me një krim tjetër”, ka çmuar, në përputhje me nenin 145 pika 2 të Kushtetutës, se dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë që parashikojnë dënimin me vdekje, si një lloj dënimi penal janë të papajtueshme me Kushtetetutën e Republikës së Shqipërisë dhe pasi ka vendosur pezullimin e kësaj çështjeje, ia ka dërguar atë për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

Kërkuesi në vendimin e tij ka parashtruar opinionin e tij lidhur me këtë çështje duke arsyetuar se:

- Kushtetuta parashikon në mënyrë të shprehur të drejtën për të jetuar si një ndër të drejtat themelore të njeriut. Mospërfshirja në Kushtetutë e dy paragrafeve që lejonin dënimin me vdekje, të cilat parashikoheshin në dispozitat e mëparshme kushtetuese, do të thotë se vullneti i ligjvënësit ka qenë që ajo normë të mos ekzistojë më;
- Aplikimi dhe ekzekutimi i dënimit me vdekje nuk përbën thjeshtë një kursim të drejtës së njeriut për të jetuar, por cënon drejtpërdrejt dhe asgjeson thelbin e kësaj të drejte themelore dhe në kuptim të paragrafit të datë të nenit 17 të Kushtetutës, ai absolutisht nuk mund të jetë i pranueshëm;
- Konventa Europiane e të drejtve të njeriut nuk e përmban një kufizim të tillë, por ajo e ndalon në mënyrë të shprehur dhe pa asnjë përjashtim dënimin me vdekje dhe sipas neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara qëndrojnë më lart se ligjet në hierarkinë e normave dhe përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik;
- Me miratimin e Kushtetutës, Kuvendi i Shqipërisë si organ ligjvënës dhe populli shqiptar me referendum kanë shprehur vullnetin dhe kanë vendosur për heqjen e dënimit me vdekje.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi shqyrtoi dokumentet, dëgjoi përfaqësuesin e Presidentit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me ligjin nr.7959, datë 11.07.1995 Kuvendi Popullor ka vendosur aderimin e Republikës së Shqipërisë në Statutin e Këshillit të Europës. Anëtarësimin e saj me të drejta të plota përfaqësimi në këtë Këshill, Republika e Shqipërisë e realizoi krahas zhvillimeve të karakterit politik, ekonomik, social dhe juridik që kishte arritur dhe kalimit gradual drejt një shoqërie të lirë e demokratike, por edhe kundrejt disa angazhimeve dhe detyrimeve të karakterit juridik ndërkombëtar, të cilat ajo i mori

përsipër për t'i përmbushur brenda disa afteve të caktuara, në bazë të Rezolutës nr. 189 të vitit 1995 të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, e shoqëruar nga vendimi i Komitetit të Ministrave nr(95) i datës 10 korrik 1995, akte të cilat sipas Statutit të Këshillit të Europës dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

Republika e Shqipërisë sipas këtyre angazhimeve ndërkombëtare detyrohej që të ratifikonte Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut së bashku me Protokollet nr.1, 2,4,7 dhe 11 të saj brenda afatit prej një viti, si dhe të nënshkruante, ratifikonte dhe zbatonte Protokollin nr.6 të kësaj Konvente, lidhur me heqjen e dënimit me vdekje, në kohë paqeje, brenda një afati prej tre vjetësh, nga koha e pranimit të saj në Këshillin e Europës, duke zbatuar një moraturium mbi ekzekutimet deri në heqjen e dënimit me vdekje.

Të gjitha këto angazhime juridike dhe politike, të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë, kanë të bëjnë me kushtet që Këshilli i Europës ka vendosur, për heqjen e dënimit me vdekje, jo vetëm ndaj shteteve anëtarë të tij, por edhe për ato shtete të cilat paraprakisht kanë fituar statusin e të ftuarit special pranë këtij organizimi.

Rezoluta nr.1044, datë 04.10.1994 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në pikën 6 të saj parashikon: "Zbatimi adekuat i Protokollit shtesë të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut duhet të mbetet një nga preokupimet e Asamblesë dhe vullneti për ta ratifikuar këtë protokoll duhet të përbëjë një kusht për anëtarësimin në Këshillin e Europës". Kjo klauzolë e karakterit juridiko-ndërkombëtar përbënte tashmë për Republikën e Shqipërisë, si një nga vendet që kishte fituar statusin e të ftuarit special, një kusht determinant për anëtarësimin e saj pranë Këshillit të Europës.

Mbi bazën e këtyre angazhimeve ndërkombëtare dhe brenda afateve të përcaktuara, Republika e Shqipërisë nënshkroi e ratifikoi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet nr.1,2,4,7 dhe 11, si dhe përmbushi mjaft detyrime të tjera të vendosura nga Asambleja Parlamentare dhe Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Europës. Ajo, gjithashtu zbatoi me korrektësi moratoriumin mbi ekzekutimet e dënimeve me vdekje, pasi që nga viti 1995 nuk është ekzekutuar asnjë person, ndaj të cilit është aplikuar ky lloj dënimi nga gjykatat. Por aktualisht Republika e shqipërisë nuk e ka përmbushur formalisht detyrimin juridik dhe politik të nënshkrimit, ratifikimit dhe zbatimit të Protokollit nr.6, i cili që në nenin 1 të tij sanksionon heqjen e dënimit me vdekje.

Sipas parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre të plotë në Kushtetutën e re, shtetet si subjekte të kësaj të drejte, janë të detyruara të përmbushin të gjitha angazhimet, që ato i kanë marrë përsipër për t'i realizuar. Përndryshe, në rast përmbushje të këtyre detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare, shtetet përkatëse nunk do të mund t'i shmangen përgjegjësisë, e cila zakonisht shfaqet shumëplanëshe, por që ndikimin më të madh e ka kryesisht në aspektin politik, juridik, ekonomik dhe social.

Nga kjo pikëpamje Republika e Shqipërisë, si një shtet që ka pranuar të aderojë në këto struktura ndërkombëtare nuk bën përjashtim. Me kalimin e tre vjetëve nga pranimi i saj në Këshillin e Europës, afat i cili është plotësuar që në muajin Qershor të vitit 1998, Republika e Shqipërisë duhej të kishte zbatuar plotësisht edhe de jure këtë detyrim ndërkombëtar, si rrjedhojë e vetë angazhimit të saj politik e juridik, duke e hequr përfundimisht dënimin me vdekje, si një nga llojet e dënimeve të parashikuar nga dispozitat e Kodit Penal.

Nënshkrimi dhe ratifikimi në afatin e caktuar i Protokollit nr.6 nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, do t'i shërbente afirmimit të kredibilitetit të Republikës së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, si një shtet që shfaq seriozitet dhe përgjegjësi në drejtim të realizimit pa hezitim të atyre angazhimeve që ajo vetë i ka pranuar, si dhe do të mbyllte përfundimisht këtë problem mjaft të diskutuar.

Megjithatë duke u nisur nga fakti i plotësimit të afatit tre vjeçar për përmbushjen e detyrimit ndërkombëtar për heqjen e dënimit me vdekje, si dhe nga zbatimi në praktikë i moratoriumit mbi ekzekutimet e personave të dënuar me këtë lloj dënimi, në të vërtetë ishte vënë në rrugën e zgjidhjes problemi i ekzistencës ose jo të dënimit me vdekje në Shqipëri, i cili që nga viti 1995 mbeti praktikisht i pazbatueshëm.

E parë në këtë këndvështrim, Kushtetuta është hartuar duke u bazuar edhe në parimet që sanksionon Statuti i Këshillit të Europës, ku në nenin 3 të tij thuhet: "Çdo anëtar i Këshillit të Europës pranon parimin e përparësisë të së drejtës dhe parimin në bazë të të cilit çdo person nën juridiksionin e saj duhet të gëzojë të drejta e njeriut dhe liritë themelore". Në këtë aspekt edhe qytetarët shqitparë si

pjesë e kësaj bashkësie europiane, ku heqja e dënimit me vdekje është bërë një domosdoshmëri, nuk mund të bëjnë përjashtim nga ky rregull dhe as nuk mund të vihen në pozita më të disfavorshme në krahasim me qytetarët e shteteve të tjera për gëzimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore. Për këtë arsye ndaj tyre mund të zbatohen vetëm ato lloj kufizimesh që në thelb nuk tejkalojnë legjislacionin europian.

Prandaj gjatë përgatitjes së Kushtetutës së re është mbajtur parasysh pikërisht ky realiteti i krijuar, si rrjedhojë dhe e atyre detyrimeve ndërkombëtare që kërkojnë heqjen e dënimit me vdekje nga legjislacioni penal.

Trajtimi si më sipër i problemit, në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe detyrimeve politike dhe juridike që Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër, shërbejnë si argumenta, të cilët së bashku me analizën e dispozitave konkrete kushtetuese, i krijojnë Gjykatës Kushtetuese mundësinë për të konkluduar lidhur me pajtueshmërinë ose jo me Kushtetutën të dispozitave të Kodit Penal që e parashikojnë dënimin me vdekje. Parë nga ky këndvështrim paraqitet e domosdoshme interpretimi i atyre dispozitave të Kushtetutës që kanë rëndësi dhe që lidhen drejtpërdrejt me këtë çështje.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj parashikon se: "Jeta e personit mbrohet me ligj". Kjo dispozitë shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës njerëzore e cila përbën një vlerë kushtetuese. Koncepti për jetën dhe dinjiteti njerëzor paraqiten në dispozitat e Kushtetutës si vlera shumë të rëndësishme, të cilat konsiderohen si burimi, nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera si të drejta themelore absolute. Kapitulli i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përshkohet që në fillim nga koncepti i mosdhunimit të këtyre lirive dhe të drejtave. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas nenit 15 të Kushtetutës, janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik, prandaj ekziston edhe detyrimi parësor dhe kushtetues i shtetit, nëpërmjet organeve të tij, që t'i respektojë dhe t'i mbrojë këto të drejta. Thelbi i dispozitave kushtetuese është nxjerrja sa më në pah e atyre drejtimeve themelore që si orientim primar kanë respektimin e vlerës së jetës dhe të dinjitetit njerëzor. Vlera më superiore për shtetin është njeriu dhe jeta e tij. Kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eleminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Jeta njerëzore duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është dhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera.

Lidhur me çështjen, objekt të kësaj kërkese, që ka të bëjë me përcaktimin e pajtueshmërisë ose jo me Kushtetutën të dënimit me vdekje, që parashikohet në disa dispozita të Kodit Penal, nuk është i mjaftueshëm referimi vetëm në nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së shqipërisë, pasi problemi paraqet domosdoshmëri të shihet në shumë aspekte të tjera, si në atë jurudik, social, politik, apo dhe historik.

Neni 21 i Kushtetutës që sanksionon mbrojtjen me ligj të jetës së personit nuk e ndalon në mënyrë të shprehur dënimin me vdekje, por kjo nuk do të thotë se e lejon, ashtu si, në të njëjtën kohë, i krijon terren mendimit tjetër se jeta e personit nuk mbrohet nga Kushtetuta, por është ligji ai që duhet të shprehet për mbrojtjen e saj. Prandaj paraqitet e nevojshme që të intepretohet kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera, me frymën që përcjell në tërësi Kushtetuta, si dhe mënyrën se si e kanë rregulluar këtë çështje dispozitat e mëparshme kushtetuese.

Sipas Ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 "Për një shtojcë në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut sanksionohen e garantohen sipas këtyre dispozitave", ndërsa neni 1 parashikonte se:

- "E drejta e çdo njeriu për të jetuar mbrohet me ligj.
- Askujt nuk mund t'i hiqet jeta, përveç se në ekzekutim të një vendimi gjyqësor për një krim tejet të rëndë, të kryer me dashje për të cilin dënimi me vdekje është parashikuar me ligj.

Dënimi me vdekje nuk mund të jepet për të rinjtë, të cilët në kohën e kryerjes së krimit kanë qenë nën moshën 18 vjeç, si dhe për gratë".

Mbi bazën e kësaj dispozite kushtetuese legjislatori miratoi Kodin Penal në vitin 1995, pa patur asnjë pengesë të karakterit kushtetues për të parashikuar dënimin me vdekje, për disa vepra të rënda penale, kod i cili aktualisht është në fuqi.

Nëse do të marrim në analizë në mënyrë krahasimore përmbajtjen e këtyre dispozitave kushtetuese me ato që sanksionohen në Kushtetutën e re, do të vinim re një dallim të ndjeshëm në aspektin e zgjerimit dhe përforcimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dallim i cili është mjaft esencial.

Neni 21 i Kushtetutës, në krahasim me nenin 1 të dispozitave kryesore kushtetuese, duke mos e parashikuar dënimin me vdekje, si një rast përjashtimor nga parimi i përgjithshëm përbën një evoluim të ndjeshëm në favor të së drejtës për jetën dhe të mosdhunimit të saj. Dispozita e mësipërme duke qenë një normë pohuese për mbrojtjen e jetës, nuk përbën njëkohësisht një mohim të saj dhe as nuk lejon alternativë në këtë drejtim.

Kështu që nga kjo pikëpamje, ligjvënësi nuk ka patur qëllimin të pranonte ekzistencën e dënimit me vdekje, si përjashtim në Kushtetutë, sepse heqja e dënimit me vdekje në Shqipëri tashmë ishte një çështje në zgjidhje. Nëse do të pranonim mendimin e kundërt, se vullneti dhe qëllimi i ligjvënësit ka qenë në favor të ekzistencës dhe të zbatimit në Shqipëri të dënimit me vdekje, atëhere ai nuk mund të mos parashikonte një dispozitë të tillë, duke përfshirë në nenin 21 të Kushtetutës së re një formulim të njëjtë me nenin 1 të dispozitave kryesore kushtetuese.

Në Kushtetutën e re janë parashikuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, megjithatë duke u nisur nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, është e kuptueshme se këto të drejta dhe liri nuk mund të konceptohen si të paprekshme dhe të pakufizuara. Vetë Kushtetuta në disa prej këtyre dispozitave e lejon në mënyrë të shprehur kufizimin e të drejtave dhe lirive, kufizim i cili konsiderohet si përjashtim nga parimi i përgjithshëm. Dhe ky kufizim kushtetues parashikohet në nenet 18/3, 26, 27, 29, 34, 35, 37, 41, 43, 45, 47/2 etj., të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, në disa dispozita kushtetuese të kapitullit të të drejtave dhe lirive themelore, legjislatori ka parashikuar vetëm rregullin e përgjithshëm, pa lejuar përjashtimin. Mungesa në mënyrë të qartë e këtij përjashtimi shfaqet në shumë dispozita kushtetuese dhe konkretisht në nenet 15, 17, pika 2, 19, 20, 22 pikat 1- 2- 3, 23 pika 1, 24 pikat 1-2-3, 25, 28, 30, 31 etj. Në këtë grup dispozitash bën pjesë edhe neni 21 i Kushtetutës, i cili duke mos parashikuar përjashtimin, nuk mund të lejojë heqjen e të drejtës së jetës nëpërmjet dënimit me vdekje.

Parimet themelore të mbrojtjes së jetës njerëzore gjejnë mbështetje të plotë në dispozitat kushtetuese. Jeta është një e drejtë, atribut fondamental i qënies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret nga shteti, njeriu në të njëjtën kohë eleminohet, si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Jeta njerëzore përbën një vlerë të padiskutueshme dhe është objekt i mbrojtjes kushtetuese, por kjo nuk do të thotë se mbrojtja e jetës së njeriut në çdo moment dhe në të gjitha rrethanat duhet të jetë e njëjtë, pasi ajo është e influencuar nga një numër faktorësh të natyrave të ndryshme, të cilat është ligjvënësi ai që i parashikon me ligj. Legjislatori është vetëm i autorizuar që të bëjë përjashtimet me ligj, kur si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese, kërkohet të hiqet jeta e dikujt.

Prandaj për të kuptuar drejt formulimin e nenit 21 të Kushtetuës, sipas të cilit jeta e personit mbrohet me ligj, është e nevojshme që ai të analizohet edhe në këtë drejtim.

Neni 21 i Kushtetutës nuk do të kuptohet plotësisht dhe interpretohet drejt, nëse nuk do të analizohet nën frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa në nenin 2, pika 2 parashikon se: “Vdekja nuk quhet e shkaktuar në kundërshtim me këtë nen, në rastet kur ajo është pasojë e përdorimit të forcës, kur një gjë e tillë bëhet absolutisht e domosdoshme:

d) për të siguruar mbrojtjen kundër dhunës të paligjshme;

e) për të kryer një arrestim të rregullt ose për të penguar arratisjen e një personi ligjërisht të burgosur;

f) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një rebelim ose një kryengritje”.

Sipas kësaj dispozite të Konventës, jeta e njeriut mund të hiqet dhe kjo lloj vdekje që i shkaktohet atij, qoftë dhe nga shteti, nëpërmjet organeve të tij, nuk ka të bëjë aspak, si dhe nuk mund të jetë e njëjtë me dënimin me vdekje, si lloj dënimi të dhënë nga gjykata, por është e lidhur me ato raste përjashtimore, shprehimisht të sipërcituara.

Në këtë kuptim duhet interpretuar ai rregullim ligjor i mbrojtjes së jetës së njeriut që kërkon neni 21 i Kushtetutës. Ligji është ai, të cilit i jepet e drejta, që në raste të veçanta dhe që kanë lidhje me vdekjen, në kuptim të nenit 2, pika 2 të Konventës, të lejojë edhe heqjen e jetës për njeriun. Konkretisht këto raste kanë gjetur rregullimin e tyre ligjor në dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal që parashikojnë institutin juridik të mbrojtjtes së nevojshme, apo në ligjin nr.8290, datë 24.02.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, i cili i jep të drejtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, forcave të policisë, rojave civile të armatosura që të përdorin armët e zjarrit në rastet e sipërpërmendura.

Pikërisht ky rregullim ligjor që i bëhet heqjes së jetës së njeriut në rastet e mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, apo të një vlere shumë më të madhe dhe të rëndësishme kushtetuese, ka gjetur

shprehjen e vet në Kushtetutë, në nenin 17, pika 1 ku thuhet: "Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve".

Pra, kufizimet që vendos Kushtetuta, sipas paragrafit të parë të nenit 17 duhen kuptuar vetëm për ato raste kur ligjvënësit i njihet e drejta të parashikojë edhe heqjen e jetës për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke mos nënkuptuar heqjen e jetës, nëpërmjet një vendimi gjyqësor, pasi dënimi me vdekje i zbatuar nga gjykata, nuk është as përjashtim dhe as kufizim që lejohet nga Kushtetuta.

Gjithashtu Kushtetuta jonë në shumë dispozita të saj dhe kryesisht në kapitullin e të drejtave dhe lirive themelore i referohet kryesisht Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa duke i respektuar në maksimum të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duke i konsideruar të drejtën për jetën dhe dinjitetin njerëzor si të drejta të padhunueshme e të pakufizueshme dhe që përbëjnë thelbin e çdo të drejte tjetër njerëzore, nuk e pranon, por e ndalon ekzistencën e dënimit me vdekje për shtetet anëtare të saj.

Prandaj është e rëndësishme që interpretimi i nenit 21 të Kushtetutës duhet parë i lidhur ngushtë sidomos me nenin 17, pia 2 ku parashikohet: "Këto kufizime nuk mund të cënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut".

Kushtetuta ka pranuar në nenet 5,116 dhe 122 se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i rradhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, në hierarkimë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve. Konventa Europiane për të Drejtat e njeriut është një nga këto marëveshje ndërkombëtare, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar dhe ratifikuar. Sipas nenit 1 të Protokollit nr.6, "dënimi me vdekje, hiqet. Askush nnuk mund të ndëshkohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet". Shqipëria nuk ka arritur që të ratifikojë aktualisht Protokollin nr.6 të Kësaj Konvente, por nisur nga fakti që Kushtetuta në nenin 17, pika 2 nuk lejon për asnjë rast kufizime të lirive dhe të të drejtave të njeriut që mund të tejkalojnë ato kufizime të parashikuara në Konventë, kuptohet se dënimi me vdekje i parashikuar nga Kodi Penal është një tejkalim i konceptit dhe frymës që krijon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe i vetë Konventës, e cila nuk e parashikon një kufizim të tillë.

I analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dënimi me vdekje është i papajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është një mohim i të drejtës për jetën dhe në vetvete përbën një dënim çnjerëzor e mizor, që shteti e realizon nëpërmjet pushtetit të tij gjyqësor. Dënimi kapital nuk lidhet me kufizimin, por me eleminimin përfundimisht të subjektit nga shoqëria. Ai është pikërisht një mënyrë e privimit të jetës së personit, i cili në këtë rast ka vetë shtetin si ekzekutor.

Dënimi me vdekje nuk i përgjigjet as qëllimit të dënimit penal, i cili përfshin shumë momente të rëndësishme që përgjithësisht ndikojnë tek i dënuari, siç janë riedukimi, izolimi, përpjekja për integrimin e tij në shoqëri etj. Masat e tjera penale që përmban Kodi Penal, duke filluar nga gjoba, burgimi deri në 25 vjet, apo burgimi i përjetshëm, si një alternativë e dënimit me vdekje, janë plotësisht të mjaftueshme, të cilat jo vetëm që përmbushin më mirë qëllimet e dënimit penal, por kur ato zbatohen me rigorozitet nga organet gjyqësore, ushtrojnë ndikimin e padiskutueshëm për ndëshkimin e fajtorëve dhe për një luftë efektive kundër kriminalitetit. Ekzistenca e kriminalitetit në këtë shkallë që është sot, si dhe lufta për pakësimin e vazhdueshëm të tij, nuk janë të lidhura në mënyrë të pandashme me prezencën e dënimit me vdekje, se sa me faktin e dobësive që vërehen ende në veprimtarinë e organeve përkatëse në aspektin e zbulimit të veprave penale, të kapjes dhe vënies përpara përgjegjësive autorëve, si dhe të aplikimit të dënimeve të përshtatshme ndaj tyre. Shpesh herë presioni që bëhet për ruajtjen e dënimit me vdekje, përveç qëllimeve propagandistike, përdoret edhe si një justifikim për mbulimin e dobësive të organeve të specializuara dhe të punës së pamjaftueshme të shoqërisë për eleminimin e shkaqeve sociale të kriminalitetit.

Dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë që parashikojnë dënimin me vdekje nuk i përmbahen frymës së Kushtetutës dhe cënojnë përmbajtjen thelbësore të të drejtës për jetën dhe dinjitetin njerëzor. Ato dispozita të Kodit Penal që e privojnë jetën e nejriut përbëjnë në vetvete një eleminim të plotë dhe të pakthyeshëm të jetës dhe dinjitetit njerëzor. Ekzekutimi i dënimit me vdekje i kryer ndaj një individi konkret, si rrjedhojë qoftë edhe e një gabimi subjektiv bëhet i pakorrigjueshëm për të dhe si i tillë individi bëhet padrejtësisht viktimë e këtij gabimi.

Duke e analizuar këtë dispozitë kushtetuese lidhur me çështjen në shqyrtim del se kufizimet në të drejtën për jetën, siç është rasti i dënimit me vdekje nuk mund të bëhet, sepse në këtë rast jo vetëm që cënohet, por mohohet tërësisht thelbi i saj. Nga ana tjetër kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk kanë të bëjnë me dënimin me vdekje si lloj dënimi penal.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzion se përmbajtja e nenit 17, pika 2 të Kushtetutës, si dispozitë parimore që vendos rregulla lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore e krijon tablonë e plotë për të kuptuar frymën dhe përmbajtjen e nenit 21 të Kushtetutës.

Ekzistenca në dispozitat e Kodit Penal e dënimit me vdekje dhe në aspektin e së drejtës ndërkombëtare që njeh ekstradimin, përbën një pengesë juridike në potencë që ndikon indirekt në drejtim të luftës kundër kriminalitetit dhe dënimit të personave. Kjo për faktin se si rrjedhojë e ratifikimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Konventës Europiane për Ekstradimin në maj të vitit 1998, persona të ndryshëm, të cilët kapen në vende të huaja si rrjedhojë e kryerjes së veprave penale në vendin tonë, nuk mund të ekstradohen në Shqipëri për t'u gjykuar dhe marrë dënimin konkret, sa kohë që vepra penale për të cilën ata akuzohen parashikon dënimin me vdekje. E në këtë drejtim, shtetet, të cilëve ju kërkohet ekstradimi nga ana e shtetit shqiptar, sipas nenit 11 të kësaj Konvente, nuk mund të akordojnë ekstradimin për persona të tillë. Kuptohet që edhe ratifikimi i kësaj Konvente nga Republika e Shqipërisë, është bërë në kushtet kur, ashtu siç u theksua më lart, problemi i ekzistencës së dënimit me vdekje kishte hyrë përfundimisht në rrugën e zgjidhjes.

Duke e analizuar këtë problem në aspektin e tij social, si dhe në kushtet e situatat që janë krijuar gjatë këtyre viteve, pa përjashtuar dhe mentalitetin tradicional në një pjesë të shoqërisë shqiptare, qëndrimi në favor të heqjes së dënimit me vdekje në Shqipëri nga dispozitat e Kodit Penal mund të intepretohet si një veprim i parakohshëm, por nga analiza e shumë elementeve të tjerë që nuk duhen injoruar, përkundrazi, duhen vlerësuar si faktorë të rëndësishëm e të padiskutueshën për shoqërinë dhe shtetin shqiptar,

- duke u nisur nga fakti se, Republika e Shqipërisë është pjesë përbërëse e një realiteti krejt të ri në përputhje me zhvillimin ligjor europian;
- meqenëse ajo ka marrë përsipër të zbatojë të gjitha angazhimet ndërkombëtare, si pjesë e këtij komuniteti ku bën pjesë;
- duke u reflektuar ky angazhim i karakterit juridik dhe politik që në vitin 1998 në Kushtetuën e re, të cilën populli shqiptar e miratoi me referendum;
- përderisa dënimi me vdekje nuk i shërben qëllimeve të vetë dënimit dhe është i papërshtatshëm për mbrojtjen e një shoqërie të civilizuar, pasi nuk është ai mjeti kryesor që ndikon në parandalimin e kriminalitetit, por janë stabilizimi i kësaj shoqërie dhe forcimi institucional i shtetit, faktorët determinantë në këtë drejtim;
- duke qenë të ndërgjegjshëm se zhvillimet qoftë politike, ekonomike, diplomatike, historike, si dhe juridiko-kushtetuese të Shqipërisë shkojnë në të njëjtin orientim dhe kah me të gjitha shtetet e tjera dhe me organizmat ndërkombëtare, ku ajo është pjesëmarrëse, dhe që vizioni i Popullit Shqiptar që në Preambul të Kushtetutës është ndërtimi i shtetit të së drejtës, demokratik e social dhe mbrojtja e dinjnitetit dhe personalitetit njerëzor;
- përderisa nënshkrimi dhe ratifikimi i Protokollit nr.6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është bërë një realitet europian;
- meqenëse Kushtetuta, si dokumenti themeltar i shtetit, i hartuar në përshtatje të plotë me parimet e Statutit të Këshillit të Europës, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, apo dhe me akte të tjera ndërkombëtare, të cilat nuk e lejojnë zbatimin e dënimit me vdekje, në kohë paqeje,

Gjykata Kushtetuese konkludon se janë pikërisht nenet 3.5.17 pika 2, 21,116 dhe 122, të cilët së bashku me Preambulën dhe në tërësi me frymën e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, jo vetëm që nuk e parashikojnë, por as nuk e lejojnë aplikimin e dënimit me vdekje në Shqipëri.

Mbi bazën e këtyre argumenteve që u parashtruan më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se dënimi me vdekje që parashikohet në dispozitat e Kodit Penal dhe konkretisht në nenet 29/1, 31, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 109, 141, 208, 209, 219, 221, 230 dhe 334 është i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

Gjithashtu meqenëse objekti i kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë është papjauteshmëria me Kushtetuën e dënimit me vdekje lidhur me disa dispozita të Kodit Penal, Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 37 të Ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", duke qenë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis tyre, vendosi të shqyrtojë tej objektit të

kërkesës edhe kushtetueshmërisë e dy dispozitave të Kodit Penal Ushtarak.

Sipas neneve 59/2 dhe 77 të këtij Kodi, në dalim nga gjashtë dispozita të tjera që janë të zbatueshme vetëm për kohë lufte, parashikohet dënimi me vdekje në kohë paqeje për veprën penale të vjedhjes së pronës ushtarake dhe për vrasjen me dashje të ushtarakut. Neni 15 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut u njeh të drejtën shteteve palë në këtë Konventë, që në raste lufte ose të ndonjë rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e një kombi, të mund të marrin masa që u shmangen detyrimeve të parashikuara në të, ndërsa neni 2 i Protokollit nr.6 të Konventës parashikon se: "një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për veprime të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës…" Pikërisht në këtë aspekt është e lejueshme nga vetë Konventa aplikimi i dënimit me vdekje në kohë lufte dhe për rrjedhojë edhe dispozitat e Kodit Penal Ushtarak që parashikojnë këtë lloj dënimi në kohë lufte nuk bëjnë përjashtim dhe si të tilla janë në përputhje me to, por nuk mund të konsiderohen të pajtueshme me Kushtetutën ato dy dispozita të sipërcituara të këtij Kodi që e parashikojnë dënimin me vdekje edhe në kohë paqeje.

Me shfuqizimin si antikushtetues të dënimit me vdekje, i përket ligjvënësit shqiptar që të rishikojë me frymën e Kushtetutës dhe të këtij vendimi, të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me dënimin me vdekje dhe në veçanti dispozitat e Kodit Penal, të cilat parashikojnë sanksionet, me qëllim që të harmonizohen në tërësi dënimet që duhen zbatuar ndaj personave që kryejnë këto vepra penale, duke parashikuar dënimet alternative dhe evitimin nga këto dispozita konkrete të dënimeve fikse.

Në këtë aspekt është e domosdoshme që të bëhen rregullimet e përshtatshme ligjore edhe në dispozitat e Kodit Penal Ushtarak lidhur me aplikimin e llojeve të ndryshme të dënimeve, kur këro vepra penale kryhen në kohë paqeje.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131, germa a", 132 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dënimit me vdekje, në kohë paqeje, në nenet 29/1, 31, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 109, 141, 208, 209, 219, 221, 230 dhe 334 të Kodit Penal dhe në nenet 59/2 dhe 77 të Kodit Penal Ushtarak.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij juridike mbi të gjitha vendimet e gjykatave të cilat përmbajnë dënimin me vdekje dhe që nuk janë ekzekutuar.

Tiranë , më 10.12.1999
Nr. 58 i Regji, Themeltar
Nr. 65 i Vendimit

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetutese
Zija Vuci,	Anëtar i""
Alfred Karamuço,	Anëtar i""
Bardha Selenica,	Anëtar i""
Kristofor Peçi,	Anëtar i""
Kujtim Puto,	Anëtar i""
Sokol Sadushi,	Anëtar i""

Me sekretare Drita Filto, më datë 19.01.2000, mori në shqyqrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.7/14 Akti që i përket:

KËRKUES: ARDIAN LIÇO, i përfaqësuar nga avokati Sinan Gjeçi, me prokurë.
OBJEKTI: Shpallja antikushtetuese e vendimeve nr.38, datë 17.07.1998 të gjykatës së rrethit Gjirokastër; nr.23, datë 14.10.1998 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr.66, datë 10.03.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se i gjithë procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj tij është rrjedhojë e shkeljes së të drejtave të tij kushtetuese duke argumentuar:

- Janë shkelur nenet 35 dhe 49/2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ndihmën e detyrueshme që i duhet dhënë të miturit, pasi i pandehuri i mitur, Elidon Roli, nën presion dhe tortura është marrë në pyetje pa mbrojtësin e tij.
- Është shkelur neni 25 i Kushtetutës që ndalon përdorimin e torturës, pasi ndaj të pandehurve është përdorur tortura;
- Është shkelur neni 32/2 i Kushtetutës dhe nenet 380, 432/c të Kodit të Procedurës Penale, pasi gjykata i ka deklaruar fajtorë mbi të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme;
- Nuk është bërë autopsia e viktimës, por vetën një përshkrim i jashtëm i saj nga mjeku ligjor nën kërcënimin e armës, në një kohë që është kërkuar zhvarrosja e kufomës, pasi kjo është konsideruar vendimtare për procesin.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuesit dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesi nuk pajtohen me konceptin që Kushtetuta e Repubublikës së Shqipërisë, Konventa për të Drejtat e Njeriut, si dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, kanë për procesin e rregullt ligjor. Gjatë proceseve gjyqësore që zhvillohen në të gjitha shkallët e gjykimit mund të vërehen shkelje të ndryshme, por e rëndësishme është, se jo çdo shkelje e ligjit që mund të konstatohet gjatë gjykimit mund të sjellë një zgjidhje të gabuar të çështjes dhe, për më tepër, të cënojë procesin e rregullt ligjor në aspektin kushtetues. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cënonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj.

Pretendimet e ngritura nga kërkuesi, që në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me analizën e provave të administruara gjatë gjykimit apo me mënyrën e vlerësimit të tyre, janë një e drejtë ekskluzive e gjykatave të zakonshme, pasi janë vetëm gjykatat më të larta, ato që mund të shqyrtojnë bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta. Gjykata Kushtetuese, duke qenë në pozicionin e autoritetit që granton respektimin e Kushtetutës dhe të organit më të lartë të specializuar të kontrollit kushtetues, nuk mund ta vendosë veten në rolin e një shkalle më të lartë gjykimi.

Në bazë të nenit 35 dhe 49/2 të Kodit të Procedurës Penale: "të pandehurit të mitur i sigurohet ndihma juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri…" dhe "…ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme". E drejta e mbrojtjes për të kontaktuar me avokatin në fillimin e procesit hetimor është një parim mjaft i rëndësishëm procedurial dhe kushtetues për zhvillimin e drejtë të një procesi gjyqësor, sepse përbën një premisë të rëndësishme për të përfituar nga garancitë ligjore kundër një procesi të paligjshëm. Megjithatë, në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, është e rëndësishme të vlerësohet nëse një kufizim ose shkelje e tillë ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë të akuzuarit të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë.

Pretendimi i kërkuesit se të pandehurit të mitur, Elidon Roli nuk i është siguruar mbrojtje që në fillim të marrjes së tij në pyetje, por më pas, nuk do të thotë se atij i është mohuar e drejta e

mbrojtjes. Pyetja e tij pa praninë e mbrojtësit në mjediset e policisë gjyqësore me datën 18.11.1998 përbën një shkelje, por kjo nuk duhet vlerësuar e shkëputur nga tërësia e veprimeve të tjera procedurale, sepse rezulton që më datën 24.11.1998, në prani të avolatit mbrojtës të tij, ky i mitur ka atribuar ndaj të pandehurve të tjerë të njëjtat thënie dhe pohuar të njëjtën ngjarje, ashtu si në gjatë pyetjes pa praninë e avokatit. Fakti që i pandehuri i mitur, edhe në prani të mbrojtësit të tij, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe gjatë pyetjes pa avokat, dëshmon se shkelja e evidentuar në fillim të procesit nuk është e atij karakteri që të cënojë procesin ligjor.

Kërkuesi, duke iu referuar faktit se gjykata e shkallës së parë ka administruar, si provë një kasetë filmike, pretendon se është shkelur neni 32 i Kushtetutës, sepse ai është dënuar mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme e në kundërshtim me rregullat procedurale penale. Administrimi i kasetës filmike vërtetohet se është kryer në kundërshtim me rregullat që parashikon neni 151 i Kodit të Procedurës Penale, por nuk është i mjaftueshëm vetëm ky fakt për të arritur në konkluzionin se i pandehuri është deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt. Kaseta filmike, sipas të dhënave të dosjes, pasqyron të njëjtin moment që rezulton edhe nga procesverbali i pyetjes së të miturit pa avokat, fakt, i cili siç parashtrohet më lart në këtë vendim, është riparuar me pyetjen e të miturit me avokat më datën 24.11.1998.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e vendimit të saj lidhur me fajësinë e kërkuesit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, nuk e ka përmendur kasetën filmike si provë, por ka analizuar tërësinë e provave të tjera, të cilat nuk rezultojnë dhe as nuk kundërshtohen nga kërkuesi si të marra në mënyrë të paligjshme. Edhe gjykata e shkallës së dytë, me arsyetimin që ajo përdor në vendimin e saj, e konsideron si rrethanë të rëndësishme faktin se kaseta filmike nuk përbën të vetmen provë dhe themeloren në përcaktimin e fajësisë së të pandehurit.

Gjithashtu, pretendimi i kërkuesit për moskryerjen e autopsisë së kufomës, në një kohë që për gjykatën është vlerësuar si i mjaftueshëm ekspertimi mjekoligjor, i cili ka dhënë një përshkrim të plotë të dëmtimeve të kufomës dhe u ka dhënë përgjigje pyetjeve të saj, si dhe pretendimi i tij për përdorimin e torturës gjatë hetimit, jenë momente që kanë të bëjnë me provueshmërinë dhe jo me cënimin e procesit ligjor.

Parregullsia e procesit ligjor në aspektin kushtetues do të konsiderohet evidente, nëse shkeljet e konstatuara gjatë gjykimit cënojnë parimet themelore të gjykimit dhe, njëkohësisht, përbëjnë thelbin e arsyetimit të vendimit të gjykatës për përcaktimin e fajësisë së të akuzuarit.

Gjykata Kushtetuese nuk shqyrton mënyrën e vlerësimit dhe as nuk bën analizën e provave të administruara në proceset gjyqësore, pasi ato janë çështje që u përkasin gjykatave të zakonshme, gjykim i të cilave nuk i përshtatet dhe nuk mund të jetë i njëjtë me mënyrën e zhvillimit të një gjykimi tepër të veçantë, siç është gjykimi kushtetues.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shkeljet e pretenduara nga kërkuesi nuk vërtetojnë se procesi ligjor ka qenë i parregullt.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131, germa “f” të Kushtetutës dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 28.02.2000
Nr.71/4 i Regj. Themeltar.
Nr.7 i Vendimit

MENDIMI I PAKICËS

Nuk pajtohem me vendimin që u mor me shumicë votash për arsyet e mëposhtme:

Në kundërshtim me pikëpamjen e shumicës dhe zgjidhjen që ajo i dha çështjes, unë kam mendimin se kërkesa e të dënuarit Ardian Liço është e drejtë dhe si e tillë duhej të ishte pranuar.

Vendimet e gjykatave të të dy shkallëve dhe të Gjykatës së Lartë, objekt i kësaj kërkese, nuk janë rezultat i një procesi të rregullt ligjor.

Kërkuesi, së bashku me persona të tjerë, është deklaruar fajtor dhe dënuar për vrasje në bashkëpunim pa u respektuar kërkesat e nenit 42/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kjo dispozitë, që garanton mbrojtjen e disa të drejtave themelore dhe midis tyre atë të lirisë, parashikon në mënyrë të shprehur se "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor".

Duke ballafaquar përmbajtjen e kësaj norme kushtetuese me procesin gjyqësor të zhvilluar kundër kërkuesit dhe personave të tjerë, del se ky gjykim, në fazën përfunditmre, i është shmangur kritereve ligjore, që përcaktojnë mënyrën e formimit të provave dhe çmimit të tyre nga ana e gjykatës.

Sipas sistemit akuzator, të pranuar në Kodin e Procedurës penale, provat formohen në gjyq vetëm nëpërmjet debatit midis akuzës dhe mbrojtjes dhe të dyja këto anë të kundërta të proceist ndodhen në një pozitë procedurale të barabartë.

Nga kjo rrjedh se kur provat e paraqitura nga njëra palë nuk pajtohen me ato të palës tjetër, sheshimi i kësaj kontradikte dhe dalja me konkluzione përfundimtare për çështjen nuk mund të arrihen vetëm duke i krahasuar këto prova midis tyre.

Gjykata, duke iu referuar qëndrimit që mban i pandehuri, edhe mund të formojë bindjen që ky nuk thotë të vërtetën, por kjo është e pamjaftueshme prë të konkluduar mbi fajësinë e tij.

Gjithashtu, i pandehuri mund të pranojë përpara prokurorit ose punonjësve të policisë gjyqësore pjesëmarjen e tij në krim, por as thëniet e kësaj natyre të marra jashtë procesit gjyqësor ose jo nëpërmjet procedurës për sigurimin e provës nuk mund të shërbejnë si bazë e vetme për ta deklaruar atë fajtor për veprën që i ngarkohet. Prokurorit, në këto raste, i bie barra që këto pohime t'i shoqërojë me prova të tjera të grumbulluara prej tij ose me çdo element tjetër provues, që mund të rezultojë gjatë debatit gjyqësor.

Vetëm në këto kushte, gjykata pranon tezën e mbrojtur nga akuza dhe del me vendim fajësie për të pandehurin, përndryshe e shkarkon këtë nga përgjegjësia.

Duke e parë çështjen nga ky këndvështrim, mendoj se në rastin konkret, gjykatat nuk i janë përmbajtur këtij parimi. Përkundrazi, në trajtimin e k]ësaj çështje ato kanë zbatuar rregullat e sistemit inkuizitor, të cilat janë të papajtueshme me legjislacionin e ri.

Kështu, ndonëse kërkuesi dhe të akuzuarit e tjerë në këtë çështje si bashkëpunëtorë në vrasje kanë mbajtur në gjyq qëndrim mohues, gjykata ka pranuar pjesëmarrjen e tyre në krim vetëm duke u mbështetur në pohimet dhe atribuimet që dy prej tyre i kanë bërë në policinë gjyqësore ose në prokurori, njëri nga të cilët në moshë madhore dhe tjetri në moshë të mitur. Madje, ky i fundit është marrë në pyetje në policinë gjyqësore pa praninë e avokatit, ndërsa kur është pyetur nga prokurori, megjithëse i është siguruar mbrojtës, nuk i është siguruar ndihma e nevojshme psikologjike, ashti siç parashikohet në nenin 35/i të Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër, në këtë rast, nuk konkurojnë asnjëri prej kushteve të parashikuara nga paragrafi i dytë i kësaj dispozite për përjashtimin e kësaj ndihme.

Pohime dhe atribuime të tilla, të pashoqëruara edhe me prova të tjera, nuk kanë asnjë vlerë provuese.

Veç sa sipër, vendimi i gjykatës së faktit ka edhe mangësi të tjera që dëshmojnë për një proces të parregullt ligjor. Në pjesën e tij arsyetuese është thënë në mënyrë të shprehur se nuk dalin të qarta rrethanat e kryerjes së krimit dhye nuk bëhet fare fjalë as për motivin e kësaj vrasjeje.

Në këto rrethana, mendoj se kjo kërkesë duhej pranuar dhe të tre vendimet gjyqësore që përbëjnë objektin e saj duhej të shfuqizohen si antikushtetuese.

Tiranë, më 28.02.2000
Nr.71/4 i Regj Themeltar

Nr. 7 i Vendimit

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i" "
Bardha Selenica,	Anëtar i" "
Kristofor Peçi,	Anëtar i" "
Kujtim Puto,	Anëtar i" "
Sokol Sadushi,	Anëtar i" "
Alfred Karamuço,	Anëtar i" "

Me sekretare Drita Filto, më datë 04.02.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.5 Akti që i përket :

KËRKUES: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
OBJEKTI: Interpretimi i nenit 179 pika 1 dhe nenit 127, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

Në kërkesë si shkak parashtrohet se:
Del e nevojshme të interpretohet nëse neni 179 pika 1 i Kushtetutës do të zbatohet apo jo për institucionet që kanë fituar mandatet me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese", por që vetë Kushtetuta e ndërpret këtë mandat me vërtetimin e njërit prej shkaqeve të përmëndura në të, siç është rasti i parashikuar në nenin 127, pika 1, gërma "c".

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të sigurohej vazhdimësia në veprimtarinë e organeve kushtetuese në nenin 179, pika 1, ka parashikuar se: "Mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute, mbaron me afatet e parashikuara në Ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse".

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 127, si shkak për mbarimin para afatit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ka parashikuar edhe mbushjen e moshës 70 vjeç (pika 1 gërma "c"), shkak i cili nuk parashikohej në nenin 23 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04. 1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Kërkesa në thelb, ka të bëjë me faktin nëse ky shkak i ri i mbarimit të mandatit para afatit, do të zbatohet për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë fituar mandatin sipas Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992, apo për ata, do të pranohen vetëm rastet e mbarimit të mandatit të parashikuara nga ky ligj.

Nga shqyrtimi i nenit 179, pika 1 të Kushtetutës, në raport me nenin 127, pika 1, shkronja "c", Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se Ligji nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse do të zbatohet për anëtarët që kanë fituar mandatet me këtë ligj, por vetëm përsa i përket afatit të zakonshëm kohor të ushtrimit të tij, i cili në bazë të nenit 18, të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 ka qenë 9 (nëntë) vjet për anëtarët e caktuar në zgjedhjen e parë dhe 12 (dymbëdhjetë) vjet, për anëtarët zëvëndësues.

Për rastet e ndërprerjes së mandatit para kohe (duke përfshirë dhe ndërprerjen e mandatit me

mbushjen e moshës 70 vjeç), ashtu si dhe për elemente të tjerë thelbësore të tij, edhe këta anëtarë, do t'i nënshtrohen dispozitave të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

Sipas nenit 179, pika 1 e Kushtetutës, Ligji nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet e plotësimet përkatëse, do të zbatohet për organet që kanë fituar mandatin sipas këtij ligji, vetëm përsa i përket afatit kohor të zakonshëm të ushtrimit të tij dhe jo edhe për shkaqet e mbarimit të parakohshëm, siç është edhe plotësimi i moshës 70 vjeç, parashikuar nga neni 127, pika 1, shkronja "c" e Kushtetutës, për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi nga dita e hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Tiranë, më 03.03.2000
Nr.5 i Regj.Themeltar.
Nr.8 i Vendimit.

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i" "
Hajredin Fuga,	Anëtar i" "
Alfred Karamuço,	Anëtar i" "
Kujtim Puto,	Anëtar i" "
Sokol Sadushi,	Anëtar i" "
Kristofor Peçi,	Anëtar i" "

Me sekretare Noela Ruço, më datë 21.12.1999 dhe 24.12.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.68/3 Akti, që i përket :

KËRKUES: NIKOLAUS E JURGEN TRESKA, të përfaqësuar nga avokat Ermir Dobjani.
SUBJEKTI I INTERESUAR: MINISTRI I DREJTËSISË, i përfaqësuar nga zoti Frederik Paskali, me autorizimin nr.12/20, datë 20.12.1999
OBJEKTI : Detyrimi i Ministrit të Drejtësisë të jap lejen për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit civil nr.1808, datë 24.04.1997 të gjykatës së rrethit Tiranë.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për pranimin e kërkesës së tyre :
1. Është cënuar prona dhe të drejtat tona të pranuara me ligj pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kemi bërë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative, prandaj kanë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave tona.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr. 1808, datë 24.04.1997 ka vendosur detyrimin e ambasadorit të Republikës Italiane që të paguajë në favor të kërkuesve qiranë e truallit të Rezidencës në shumën 3424 dollarë amerikanë në muaj. Vendimi ka marrë formën të prerë dhe zyra e përmbarimit Tiranë në përputhje me kërkesat e nenit 526 të Kodit të Procedurës Civile, i ka kërkuar ministrit të Drejtësisë dhënien e lejes për egzekutim.

Meqënëse nga ministri i Drejtësisë nuk jepej leja përkatëse, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr.55, datë 27.10.1998 nuk e kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, me arsyetimin se ekzistojnë mundësi të tjera të pashfrytëzuara që kjo mosmarrëveshje të zgjidhet në rrugë administrative. Pas këtij vendimi, kërkuesit i janë drejtuar përsëri ministrit të Drejtësisë dhe Kryeministrit për të zgjidhur çështjen dhe pasi nuk kanë marrë përgjigje, kanë përsëritur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar se mosekzekutimi i vendimit të gjykatës vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 142/3 të Kushtetutës .

Për zgjidhjen e drejtë të çështjes, Gjykata Kushtetuese iu referua edhe Konventës së Vjenës, datë 18 prill 1961 " Mbi Marrëdhëniet Diplomatike", në të cilën shteti ynë është palë.

Sipas Konventës së Vjenës, agjenti diplomatik, i cili, me disa përjashtime, që përmenden në nenin 31/1, gëzon imunitetin e juridiksionit penal, civil dhe administrativ të shtetit pritës. Ky parim i Konventës është sanksionuar edhe në nenin 39 të Kodit te Procedurës Civile, sipas të cilit anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë, nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur pranojnë vullnetarisht ose kur objekti i padisë ka të bëjë me sende të paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë. Por, në lidhje me objektin e padisë, në dallim nga neni 39 i Kodit të Procedurës Civile, Konventa ka bërë edhe një përjashtim. Kështu, sipas nenit 31/1 gërma "a" dhe nenit 1/ë të Konventës, agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit për veprime lidhur me një ndërtesë private ose terrenin përkatës që ndodhet në teritorin e shtetit pritës, kur e posedon atë për llogari të shtetit akreditues për qëllimet e misionit.

Në këto rrethana, duke patur parasysh hierarkinë e akteve normative sipas nenenve 116 dhe 122/2 të Kushtetutës, marrëveshja ndërkombëtare ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohet me të. Prandaj, në këtë rast, do të zbatohen kërkesat e nenit 31/1, gërma "a" të Konventës së Vjenës.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesve se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore vjen në kundërshtim me nenin 142/3 të Kushtetutës, për rastin konkret, ai është i pabazuar. Sipas kësaj dispozite, asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Por, në rastin konkret, organet përkatëse shtetërore shqiptare, nuk mund t'i marrin ato masa, sepse i pengojnë detyrimet që ka marrë shteti shqiptar, sipas Konventës së Vjenës dhe frymës së Kushtetutës.

Prandaj, kërkesa e kërkuesve Nikolaus e Jurgen Treska duket të rrëzohet si e pa bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe nenit 41 të Ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998 " Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 10.03.2000
Nr.68/3 i Regj.Themeltar.
Nr.11 i Vendimit.

VENDIM
NË EMËR TE REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga :

Thimjo Kondi	Kryesues
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	"
Natasha Sheshi	"
Vangjel Kosta	"
Metush Saraçi	"
Vladimir Metani	"
Vladimir Bineri	"
Zamir Poda	"
Bashkim Caka	"
Tefta Zaka	"
Ylvi Myrtja	"

në seancën gjyqësore të datës 29.07.1999 mori në shqyrtim çështjen civile nr.156 që i përket

TË PANDEHURVE: BAKI HUQI
ALBERT HUQI mbrojtur nga Av. Shefqet Muçi

AKUZUAR: Për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76-25 të Kodit Penal dhe vrasjes me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 76-22-25 të Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Durrës, me vendimin Nr.205, datë 30.10.1998, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Baki Huqi për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim dhe vrasjes me dashje në bashkëpunim mbetur ne tentativë dhe përfundimisht në bazë të neneve 76-25, 76-22-25 të Kodit Penal dhe 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Baki Huqi për veprat penale të parashikuara nga nenet 238, 278/ 2 të Kodit Penal.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Albert Huqi për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim dhe vrasjes me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë dhe përfundimisht në bazë të neneve 76-25, 76-22-25 dhe 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 48, datë 10.03.1999 ka vendosur:

Prishjen e vendimit penal Nr.205, datë 30.10.1998 të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe kthimin e akteve po kësaj gjykate për të pandehurin Baki Huqi për t'u rigjykuar nga një tjetër trup gjykues.

Prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes për sa i përket të pandehurit Albert Huqi mbasi nuk vërtetohet fajësia e këtij të pandehuri.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bëre rekurs prokurori i apelit dhe ka parashtruar këto shkaqe për prishjen e tij. Nga hetimet paraprake dhe gjykimi i çështjes në shkallë të parë është provuar plotësisht fajësia e të pandehurit Albert Huqi.

Vendimi i Gjykatës së Apelit është kontradiktor, sepse ndonëse për të pandehurin Albert Huqi ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pushimin e gjykimit të çështjes për shkak se nuk vërtetohet fajësia e tij, për të pandehurin tjetër Baki Huqi që ia kthen çështjen për rigjykim gjykatës së rrethit në arsyetim të vendimit pranon se vepra është kryer në bashkëpunim duke nënkuptuar përsëri kështu për të pandehurin tjetër.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Të angazhuar me vendimin Nr. s' ka, datë 16.06.1999, për ndryshim të praktikës gjyqësore ,pasi dëgjuan relacionin përkatës, prokurorin Mihallaq Bleta që kerkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes , avokatin Shefqet Muçi që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykates së Apelit , mbasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

V Ë R E N:

Vendimi Nr. 48, datë 10.03.1999 i Gjykatës së Apelit Durrës duhet të prishet për shkak se është zbatuar gabim ligji procedurial.

Të pandehurit Baki dhe Albert Huqi akuzuar për vrasje me dashje në bashkëpunim sipas nenit 76 e 25 të Kodit Penal ndonëse janë njoftuar disa herë nga gjykata e shkallës së parë për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk janë paraqitur e meqënëse njoftimet e bëra ishin konform kërkesave të nenit 141 të Kodit të Procedurës Penale; gjykata e rrethit Durrës në bazë të nenit 351 të K.Pr.Penale ka deklaruar mungesën dhe ka gjykuar çështjen në mungesë të tyre duke i deklaruar fajtorë dhe dënuar për veprat që akuzoheshin. Në këtë rast të pandehurit janë përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve sipas nenit 48/2, 3 të K.Pr.Penale dhe i paisur me akt përfaqësimi të përpiluar përpara noterit me datë 13.03.1997.

Mbi ankimin e avokatit mbrojtës , Gjykata e Apelit Durrës ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës duke deklaruar të pandehurin Albert Huqi të pafajshëm për vrasje sipas nenit 76-25 të Kodit Penal , ndërsa për të pandehurin tjetër Baki Huqi ka kthyer çështjen për rigjykim po pranë Gjykatës së Rrethit Durrës me detyrat përkatëse.

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë, se avokati mbrojtës i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve nuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë. Pavarësisht nga zgjidhja në themel të çështjes mbi ankimin e tij, Gjykata e Apelit nuk duhej të investohej, për gjykimin e çështjes për rrjedhojë vendimi i saj duhet të prishet dhe çështja të pushohet.

Në rastet kur procedohet për gjykimin e çështjes në mungesë, sipas neneve 141 dhe 351 të Kodit të Procedurës Penale, kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur ose të pranuar prej tij, organi procedues ka detyrimin ligjor t'i caktojë të pandehurve mbrojtës kryesisht, ndërsa për rastin konkret në vend të tij gjykata ka pranuar mbrojtësin e zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve duke plotësuar kështu detyrimin ligjor sipas nenit 351 të K.Pr.Penale. Nga ky moment mbrojtësi merr të gjitha atributet e të pandehurit në mungesë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave proceduriale , për bërjen e kërkesave dhe kundërshtimeve lidhur me atë fazë gjykimi, por mbas dhënies së vendimit mbrojtësi përfundon së qëni palë në gjykim e për pasojë nuk gëzon më të drejtat që ligji u njeh palëve në procesin penal. Ushtrimi i ankimit në Gjykatën e Apelit nga mbrojtësi i të pandehurve në mungesë Baki dhe Albert Huqi është bërë në kapërcim të të drejtave që ligji i njeh atij, në fazë të caktuar të procedimit.

Në nenin 407 të K.Pr. Penale përcaktohen rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit sipas paragrafit të tretë të kësaj dispozite i takon vetëm atij që ligji ja njeh shprehimisht dhe kur ai nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilit prej tyre. Në përputhje me këtë gjendet edhe përcaktimi i nenit 50/1 i K.Pr.Penale, sipas të cilit mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit përveç atyre që i rezervohen atyre personalisht. Ligji procedurial penal njeh një sërë të drejtash ekskluzive për të pandehurit si e drejta për të zgjedhur ose pranuar mbrojtës, për të pranuar ose jo veprën penale që i atribuohet, për të dhënë shpjegime, për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës etj. Të drejtat proceduriale të përmendura më lart gjejnë shprehje edhe në nenin 410/1 të K.Pr.Penale, ku thuhet, se i pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, ndërsa në rastin e gjykimit në mungesë sipas nenit 410/2 të K.Pr.Penale, ku i pandehuri nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit ketë të drejtë ligji ia njeh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj. Autorizimi duhet të jetë akt i lëshuar në format e kërkuara nga ligji, pra të lëshohet personalisht nga vetë i pandehuri vullneti i të cilit vërtetohet sipas rastit nga noteri ose organi që e njeh ligji dhe në të duhet të delegohet shprehimisht e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor.

Aplikimi i të drejtës së ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në mungesë të të pandehurve nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve mohon të drejtën

e tyre për të ushtruar ose jo ankim kundër vendimit të gjykatës, sepse mbrojtësi që ka bërë ankimin nuk është zgjedhur ose pranuar nga vetë të pandehurit Baki dhe Albert Huqi.

Mbrojtja e caktuar kryesisht ose për efekt të plotësimit të këtij detyrimi ligjor e pranuar nga gjykata, mbrojtja e zgjedhur nga familjarët e të pandehurve në mungesë presupozon garantimin e një procesi të rregullt dhe të drejtë ligjor, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave proceduriale të të pandehurit ,por kursesi disponimin tërësor mbi të drejtat që atij i njeh ligji. Vetëm në rastin kur një i pandehur është nën kujdestari ligji parashikon që kujdestari ka të drejtë të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit, ndërsa në rastet e tjera askush nuk mund të legjitimohet pa patur pëlqimin e të pandehurit. Në këto rrethana në mungesë të të pandehurit pëlqimi i të afërmëve të tij për t'i dhënë të drejtë mbrojtësit të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë është i pamjaftueshëm. Pranimi i ankimit të bërë nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve iu mohon atyre të drejtën të bëjnë vetë ankimin ose nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tyre, prandaj ndodhur në këto rrethana Gjykata e Apelit nuk duhej të shqyrtonte çështjen në shkallë të dytë, por në bazë të nenit 420/2 i K.Pr.Penale të vendosë mospranimin e ankimit me arsyetimin se mbrojtësi nuk legjitimohej në bërjen e ankimit.

Mbas gjykimit të çështjes në mungesë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë i njoftohet të pandehurit konform kërkesave të nenit 140,141, të K.Pr.Penale. Lajmërimi i depozitimit të vendimit afishohet në banesën e të pandehurit, qendrën e punës, ju komunikohet fqinjëve ose të afërmëvetë tij, ndërsa në rastin e të pandehurit që i fshihet ndjekjes penale ligji parashikon njoftimin e tij nëpërmjet dorëzimit të aktit mbrojtësit të tij dhe kur nuk ka të tillë mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Mbas respektimit të të gjitha rregullave të mësipërme vendimi konsiderohet ligjërisht i njoftuar dhe për të pandehurin fillon përllogaritja e afatit të ankimit. Plotësimi i afatit ligjor i jep vendimit formën e prerë dhe në rastin e mungesës ankimohet vetëm në kushtet e caktuara ligjore.

Pra i pandehuri i deklaruar në mungesë sipas nenit 351 të Kodit Pr.Penale nuk humbet të drejtën e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë ndaj tij vetëm se duhet të realizojë këtë të drejtë duke kërkuar fillimisht rivendosjen në afat të ankimit sipas nenit 147/2 të K. Pr. Penale dhe të vërtetojë se nuk ka marrë dijeni për vendimin. I pandehuri mund të paraqesë kërkesën për rivendosjen në afat sipas rastit në vartësi me vendin ku ndodhet çështja për gjykim në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë dhe mbas rivendosjes në afat të dyja këto gjykata janë të detyruara të gjykojnë dhe shqyrtojnë çështjen në themel.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 47, datë 28.01.1999 për të unifikuar praktikën gjyqësore kanë legjitimuar mbrojtësin e caktuar kryesisht të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, por në të njëjtin pozicion procedurial konsiderohet edhe mbrojtësi i të pandehurve në mungesë Baki dhe Albert Huqi, sepse pavarësisht se është zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve ai është lejuar dhe pranuar në gjykim për të zëvëndësuar mbrojtësin që gjykata duhej të caktonte kryesisht për të plotësuar detyrimin ligjor që ajo kishte sipas nenit 351 të K.Pr.Penale.

Për arsyet e përmendura më lart çmohet se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nuk është i drejtë dhe krijon anomali në zhvillimin e procesit penal prandaj diktohet e nevojshme marrja e një vendimi tjetër nga Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e një praktike gjyqësore tjetër të ndryshme nga ajo e deritanishmja në mënyrë që mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve të konsiderohet person i palegjitimuar për bërjen e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurve.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 441 "c" të K.Pr. Penale .

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.48, datë 10.03.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Unifikimin e praktikës gjyqësore sipas arsyetimit të mësipërm.

Tiranë, më 29.07.1999

ANËTAR Kundra N. Kita	ANËTAR A.Hoxha	KRYESUES Th.Kondi
ANËTAR N.Sheshi	ANËTAR Kundra B.Caka	ANËTAR Y Myrtja
ANËTAR M.Saraçi	ANËTAR V.Kosta	ANËTAR T.Zaka
ANËTAR Z.Poda	ANËTAR V.Bineri L.H	ANËTAR V.Metani

MENDIM I PAKICËS

Ndryshe nga sa konkludon shumica, kemi mendimin se mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit .

Të pandehurit Baki dhe Albert Huqi janë akuzuar për vrasje në bashkëpunim sipas nenit 76 të Kodit Penal.

Ndonëse janë njoftuar dhe kërkuar nga organi procedues i akuzës nuk janë paraqitur. Po ashtu nuk janë paraqitur as edhe në gjykimin e çështjes prandaj në bazë të nenit 141 të K.Pr.Penale eshtë marrë vendim për mosgjetjen e tyre dhe në bazë të nenit 351 të K.Pr.Penale gjykata ka deklaruar mungesën e të pandehurve. Konform dispozitave të lartëpërmendura në rast se i pandehuri nuk ka mbrojtës organi procedues ka detyrimin që të pandehurit në mungesë t'i caktojë një mbrojtës kryesisht që ta përfaqësojë, veprim i cili nuk është kryer nga organi procedues, për shkak se të afërmit e të pandehurit kanë zgjedhur mbrojtësi i cili pasi është pajisur me akt përfaqësimi të përpiluar përpara noterit ka marrë të drejtën për t'i mbrojtur dhe përfaqësuar të pandehurit në të gjitha shkallët e gjykimit.

Në këto rrethana përderisa mbrojtësi është zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit, e drejtë e tyre kjo bazuar në nenin 48/2/3 të K.Pr.Penale dhe është pajisur me akt përfaqësimi noterial , mendojmë se ankimi i tij gjen mbështetje në nenin 410 /2 të K.Pr.Penale dhe duhet të investojë gjykatën për shqyrtimin e çështjes. Në bazë të kësaj dispozite kundër vendimit të dhënë në mungesë mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është pajisur me akt përfaqësimi në format e parashikuara në ligj, pra jo në çdo formë por vetëm në format ligjore një prej të cilave është edhe dhënia e aktit të përfaqësimit nga të afërmit e të pandehurit sipas nenit 48/2/3 të K.Pr.Penale. Duke ju referuar përmbajtjes së neneve 141 dhe 351 të K.Pr.Penale pas marrjes së vendimit për mosgjetjen e të pandehurit dhe deklarimit të mungesës organi procedues ka detyrimin ligjor të caktojë një mbrojtës kryesisht që e përfaqëson të pandehurin. Nga terminologjia e përdorur, konstatohet, se në këtë rast mbrojtësi nuk është vetën ndihmës për garantimin e të drejtave proceduriale dhe mbrojtjen e interesave të të pandehurit, por edhe përfaqësuesi i tij me të drejtat që përmenden në aktin e përfaqësimit. Pra, përderisa është respektuar forma ligjore , mbrojtësi përfaqësues mund të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës edhe pa dijeninë e të pandehurit.

Për rastin konkret nuk cënohet e drejta e të pandehurit për të bërë vetë ankim kundër vendimit, sepse nenet 410/1/2 të K.Pr.Penale, krahas të pandehurit nuk përjashtojnë as të drejtën e mbrojtësit për të bërë ankim, por gjithmonë me pëlqimin e të pandehurit, kur ky është i pranishëm dhe kur pajiset me akt përfaqësimi në format e parashikuara në ligj, kur ai është në mungesë si është dhënia e aktit të përfaqësimit nga të afërmit e të pandehurit sipas nenit 48/1/ 2 të K.Pr.Penale . Në këto kushte mendojmë, se nuk veprohet as në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 50 pika 1 e

K.Pr.Penale ku thuhet, se mbrojtësi i ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit.

Në pamundësi që i pandehuri të bëjë vetë zgjedhjen, mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e tij nuk cënon, por mbron dhe garanton të drejtat proceduriale të të pandehurit në mungesë.

Pas shpalljes së vendimit dhe njoftimeve përkatëse sipas neneve 384 dhe 386 të K.Pr.Penale për të pandehurin në mungesë vendimi merr formën e prerë dhe mund të vihet në ekzekutim në çdo kohë. Fakti që në bazë të nenit 147/2 i K.Pr.Penale i pandehuri ka të drejtë, të kërkojë rivendosjen në afat nuk do të thotë se atij i është garantuar e drejta e ankimit sepse kjo varet nga çmuarja që do të bëjë pë çdo rast organi i procedurës që do të marrë në shqyrtim kërkesën.

Përveç sa sipër vendimi mund të ankimohet nga të pandehur të tjerë të pranishëm që akuzohen në bashkëpunim me të pandehurin në mungesë ose nga palë të tjera në proces si prokurori etj., mbi ankimin e të cilit në bazë të nenit 425 pika 2/a,b,c e K.Pr.Penale edhe mund të rëndohet pozita e të pandehurit në mungesë dhe pasi të kalohen të gjitha shkallët e gjykimit duke u shqyrtuar çështja në tërësi vendimi të marrë formën e prerë edhe për të pandehurin në mungesë. Kështu atij i hiqet mundësia që të kërkonte qoftë edhe rivendosjen e afatit të ankimit. Sipas nenit 147/2, 148 të K.Pr.Penale kjo e drejtë mund të realizohej derisa çështja është për shqyrtim në një nga shkallët e procesit gjyqësor, ndërsa pas përfundimit të procesit deri në Gjykatën e Lartë nga pikëpamja proceduriale nuk mund të bëhet më fjalë për rivendosje në afat të ankimit, sepse gjykatat nuk mund të dispononi më mbi vendimet e mëparshme. Ato nuk mund të gjykonin më sërish për të njëjtin person dhe për të njëjtën vepër penale, ndryshe do të vepronin në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pra pas ankimit të palëve të tjera në proces vendimi merr formën e prerë edhe për të pandehurin në mungesë, ndërsa këtij të fundit që nuk ka mundësi të zgjedhë vetë i mohohet edhe e drejta e ankimit nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e tij sipas nenit 48/2/3 të K.Pr.Penale, pra i mohohet e drejta të ankimojë një vendim që e deklaron fajtor dhe e dënon për një vepër penale.

Duke parë e vlerësuar në tërësi të gjitha dispozitat e lartëpërmendura konstatojmë, se pozita e të pandehurit në mungesë në aspektin procedurial është më e mbrojtur duke legjitimuar mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë ndërsa moslegjitimimi i tij ndikon për mosgarantimin e të drejtave proceduriale, mbrojtjen e interesave të të pandehurit dhe në tërësi pengon zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor konform kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

B.Caka N.Kita

Nr. 156 i Regj. Themeltar.
Nr. 386 i Vendimit

U dorëzua për shtyp më 19.4.2000
Doli nga shtypi më 21.4.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë